

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7584 E martë 10 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ANDI BUSHATI



Majko, dëshmitari i fundit
i një PS-je që ka vdekur

Vendimi i ish-dy herë kryeministrit të PS-së për të mos votuar ligjin, sa grabitqar po aq edhe harbut, për shembjen e teatrit, nuk ishte thjesht një ...
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga ALEJO VIDAL-QUADRAS



Dënimi i komplotit
terrorist të Iranit në Europë

A gjencitë belge të Inteligjencës dhe Sigurisë kanë shpallur se kanë parandaluar një komplot terrorist, që kishte në shënjestër mbledhjen e madhe të opozitës ...
Vijon në faqen 21



INTERVISTA 2 / SABAH GOCI: SHITESA MINIMALE 369 LEKE, MAKSIMALJA 980 LEKE

PENSIONET, EKSPERTI: SA RRITEEN PER ÇDO KATEGORI

730 persona përfituan nga indeksimi prej 2.8%. Specialisti i Institutit të Sigurimeve shpjegon kompensimin për pensionet para 2015-ës



(Në foto) Eksperti i pensioneve, Sabah Goci

Reforma në drejtësi, shtyhet projektligji
**"Magjistratët",
Ballë: Komunikojmë
me LSI-në për të
plotësuar 84 vota**

Përgjigjet Vasili: Nuk ka asnjë komunikim zyrtar me PS. Naço: Pse jemi kundër draftit

DARINA TANUSHI

Partia Socialiste kërkoj dje përmes kreut të grupit parlamentar, Taulant Balla shtyrjen e ligjit për magjistratët e rinj, që kërkon 84 vota. Balla u shpreh se kjo kërkesë vjen për shkak të mungesës së opozitës në seancë ...
Në faqen 2

TURQI

Erdogan betohet
si president,
Edi Rama dhe Hashim
Thaçi në ceremoni

Në faqen 16

LISTA E ATP

1.100 pronarët që
përfitojnë nga
kompensimi, fondi
1.7 miliardë lekë

Në faqen 11

HETIMI

"Toyota"-t me
3.4 milionë euro,
nisen letër-porosi
në tri shtete

Në faqen 5

DESHMIA NE "NEWS 24"

U godit me thikë
e vdiq në spital,
motra e tregtarit:
Autori u la i lirë

Në faqen 8

ZV.REKTORI



Stefan Qirici:
**"Luarasi" merr
vlerësim maksimal nga
akreditimi institucional**

Në faqen 18

Ish-presidenti, i ftuar në "Studio e Hapur", në televizionin "News 24"

Moisiu: Rama, kryeministri më i mirë pas '90

"Rrjeta e drejtësisë? Po përmend Balzakun: Është, por jo për 'mizat e mëdha'"

Kryeministri më i suksesshëm? Kjo ishte pyetja e radhës e gazetares Eni Vasili, drejtuar ish-presidentit Alfred Moisiut në emisionin "Studio e Hapur". Ky i fundit u përgjigj se është e vështirë për të dhënë një emër, por gjithsesi ai zgjodhi



kryeministrin aktual, Edi Rama. Eni Vasili: Kush është sipas jush kryeministri më i suksesshëm? Alfred Moisiu: Është e vështirë, sepse në periudha të ndryshme kanë qenë situata të ndryshme. Për shembull, procesi i llogaridhënies është gjë ...
Në faqen 4

PARLAMENT DEBATET

Darina Tanushi

Partia Socialiste kërkoi dje, përmes kreut të grupit parlamentar Taulant Balla shtyrjen e ligjit për magistratët e rinj, që kërkon 84 vota. Balla u shpreh se kjo kërkesë vjen për shkak të mungesës së opozitës në seancë, "asaj opozite që dy vite më parë e votoi me konsensus reformën në drejtësi, pjesë e së cilës është dhe ky pr/ligj, që i mundëson ekselentëve në Juridik të vijojnë kursin e magistraturës". "Ky pr/ligj që vjen sot, (dje) ka si qëllim që t'i mundësojë juristëve të rinj të regjistrohen në kursin e magistraturës. Flasim për ekselentët e fushës. Dua të them se mungesa e opozitës është e pashpjegueshme, pasi dy vite më parë, ky pr/ligj u votua nga 140 deputetë dhe nuk kishte asnjë kundërshti. I ftoj kolegët e LSI, por dhe ata të Partisë Demokratike të bëhen pjesë e votimit në kuadër dhe të frymësojnë bashkëpunimit që karakterizoi votimin e paketës së ligjeve të reformës në drejtësi të dy viteve më parë", tha Balla. Sipas votimit të dy viteve më parë, vijoi ai, "na u dha kohë dy vite për të përgatitur këtë bazë ligjore, tashmë disa javë përpara se ky afat të mbyllet, do ishte e udhës të votonim këtë pr/ligj të gjithë së bashku. Duke parë që ky pr/ligj kërkon 84 vota dhe opozita sot nuk është e pranishme, kërkoj shtyrjen e diskutimeve dhe votimit për këtë pr/ligj në seancën e radhës, datë 19 korrik", tha Balla. Në prononcimin e tij për gazetarët Balla pohoi se nuk i kishin 84 votat që duheshin për ta kaluar këtë ligj. "Ne duam dhe kemi prirjen që ky të jetë një proces të paktën me konsensus me njërin prej forcave politike në opozitë", tha Balla. I pyetur nëse do i bëjnë ftesë LSI-së, Balla tha: "Ftesa ime është për deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim po të kemi parasysh që sot e një vit për këtë çështje kemi pasur të njëjtin pozicion. Kjo çështje sot e një vit nuk ka ndryshuar aspak, as në formë e as në përmbajtje. Pra, e themë e gjithë kjo unë mendoj që jemi në kohën e duhur për t'u mundësuar në shtator djemve dhe vajzave ekselent në drejtësi që të vijojnë studimet në nivelin më të lartë të studimeve në këtë fushë sikurse është magistratura". Balla tha se kanë një komunikim zyrtar me Lëvizjen Socialiste për Integrim për këtë çështje. Por, shtoi ai më tej, "dua të theksoj që e rëndësishme në këtë proces është që të ruajmë konsekuencën e qëndrimeve tona për një çështje të caktuar. Për çështjen e

PS kërkoi dje në seancë shtyrjen e projektligjit për mungesë votash

"Magjistratët", Taulant Balla: Jemi në komunikim me LSI për të bërë 84 vota


"Nëse nuk do ishte 'çadra', institucionet do të ishin ngritur"



Kreu i grupit parlamentar socialist Taulant Balla

PETRIT VASILI

Kryetari i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili hodhi poshtë deklaratën e Taulant Ballës, i cili tha se ka një komunikim zyrtar me LSI për ligjin e magistraturës. Në një intervistë për 'Ora News', Vasili tha se nuk ka asnjë komunikim me mazhorancën. "Nuk ka asnjë komunikim dhe ka zero komunikim zyrtar me PS për nisma ligjore për të cilat bëhet fjalë, siç është statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, ka zero komunikim zyrtar me PS", - tha Vasili.



Gjatë një seance parlamentare

PANDELI MAJKO

Pandeli Majko, i cili nuk mori pjesë në votimin për projektligjin që i hap rrugë ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar, u rikthye dje në seancën e parlamentit. Fotot kanë fokusuar Majkon duke biseduar me kreun e grupit parlamentar socialist Balla në sallën e Kuvendit. Gjithashtu, Majko shihet duke biseduar me Kumbaron, me të cilën nuk dihet nëse ka folur për teatrin.



Deputeti i LSI-së sqaron kundërshtimet për ligjin e magistratëve

Naço: Anëtarët e KLD, llumi i drejtësisë, shumica ka frikë

Deputeti i LSI-së, Nasip Naço sqaroi dje, arsyet se përse LSI është kundër ligjit për magistratët. Në një deklaratë për mediat, Naço u shpreh se KLD është 'llumi i drejtësisë, por në krye të këtij institucioni është ish-kryetari i LSI, Presidenti Meta. "Unë personalisht dhe në emër të grupit të LSI nuk kam pranuar që të votoj nenin 1, që t'i japim edhe njëherë mundësi KLD, këtij këshilli të anatemuar nga ne dhe ndërkombëtarët nga emërimet nepotike. Këtij këshilli i propozova 44 gjyqtarë për shkarkim, por nuk më mbështeti, po ashtu edhe ministres aktuale të Drejtësisë. Si mundet t'u japim mundësi këtyre anëtarëve të KLD, llumi i drejtësisë, që t'u kërkojnë ndere magistratëve", tha Naço. "Unë personalisht dhe grupi i LSI nuk mund të votojmë nenin 1, pra 160, që ka të bëjë me emërimin e studentëve magistratë. Ligji i vjetër parashikonte që shkarkimet t'i bënte prokurorja e përgjithshme, por ajo që do i emërojti sot do u kërkojë votën më vonë. Në komisionin e ligjeve që numri 25, të shkante në 50 në shkollën e magistraturës, pasi një pjesë e gjyqtarëve do të largohen. Por u hoq viti akademik 2018-19, pasi nuk duan që reforma të ecë para, nuk duan të krijohet KLGJ dhe KLP. Frika nuk është e opozitës, por e shumicës, janë ministrat e shumicës që janë vendosur para drejtësisë", tha ish-ministri i drejtësisë.

Shkollës së Magistraturës edhe dy forcat politike LSI dhe PD duhet t'i qëndrojnë konsequent atij qëndrimi që kanë pasur dy vite më parë. Pra, dakordësinë për të vijuar

procesi i pranimeve. Këtu kujtoj, dhe dua të jetë shumë e rëndësishme për çdo qytetar, pse jemi sot në kohë vonesë dhe na duhet të ndryshojmë një aspekt që ka të bëjë me

Tabaku: Shqiptarët taksohen më shumë, oligarkët përfitojnë

Ahmetaj, opozitës: Kemi ulur taksat dhe çmimet, s'keni kontribuar

Kuvendi miratoi dje, ligjin "Për një shtesë në ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Por në këtë projektligj, shumica rrezoi një amendament të propozuar nga Erjon Braçe dhe Evis Kushi. Në projektligjin për shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind që aplikohet për agroturizmin, Braçe dhe Kushi kërkuan përmes amendamentit që të përfshihen edhe pijet e prodhuara nga vetë struktura, por që u rrëzua. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj u shpreh se një propozim i tillë nuk mund të miratohet, pasi nuk ka arsye që të përjashtohen nga taksat. Ministri



Arben Ahmetaj nga foltorja e Kuvendit iu kundërpërgjigj akuzave të opozitës për rritje të taksave dhe çmimeve, pavarësisht se ajo mungon. Kreu i Financave tha se ka pasur ulje çmimesh për shumë produkte, ndërsa shtoi se pretendimet e opozitës nuk janë të vërteta. Mes të tjerash ai tha se opozita nuk ka kontribuar në konsolidi-

min fiskal. "Ju e rritët borxhin (i drejtohet opozitës). Ne jo vetëm që ulën taksat, por po ulim dhe borxhin. Qeveria kursen dhe trajton borxhin e trajtuar nga ju o të munguar", tha Ahmetaj, duke iu drejtuar opozitës. nga ana e saj, deputetja e PD-së, Jorida Tabaku tha se me këtë qeveri janë rritur taksat. Përmes një postimi në 'Facebook' së bashku me një tabelë me shifra, Tabaku tha se qeveria flet për rritje të sektorëve ekonomikë ndërkohë që i vetmi sektor sipas saj është rritur është ai i oligarkëve pranë tyre. Sipas Tabakut, vetëm me paketën fiskale 2018, rritën takset e pronës 2 deri më 4 herë.

afatin? Sepse pas miratimit të paketës së reformës në drejtësi në korrik, në këtë të xehët të ngjashëm sikurse edhe sot, na ndodhi një vonesë arsyet e së cilës ju i dini. Vonesa

ishte çadra", tha Balla. Sipas tij, "nëse nuk do të ishin 3-4 muajt e çadrës, sot do të kishim 3-4 muaj më shumë kohë në dispozicion dhe në 3-4 muaj kohë, do të ishte edhe

KLGJ edhe KLP, dy institucionet e reja të organizuar së re të drejtësisë në vend, nuk do të kishte më nevojë për të ndryshuar këtë afat të shkollës e Magistraturës".



Ruçi: S'ka përsëritje. PD: Epidemi hajdutësh, mazhoranca vjedh votat si në diktaturë

Teatri Kombëtar, Kuvendi rrëzon opozitën: Votimi, i rregullt

Në vend të Tavos votoi Bitri i LSI

Valentina Madani

Pretendimi i dy partive të opozitës, PD dhe LSI se është manipuluar votimi për ligjin e posaçëm për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar, i çoi ata në bojkotimin e seancës së djeshme. Por votimi i ligjit për Teatrin Kombëtar në seancën e së enjtes së shkruar është i vlefshëm. Në këtë konkluzion arriti Sekretariati për Procedurat dhe Votimet në Kuvend pas investigimit të bërë lidhur me procesin, duke rrëzuar kështu kërkesën e PD-LSI për shpalljen të pavlefshëm të votimit dhe përsëritjen e tij. Opozita pretendonte për manipulim dhe vjedhje votash. Në fakt, gjithçka lidhet me votimin e deputetit Robert Bitri me kartën e deputetit Vangjel Tavo. Vota e këtij të fundit u numërua pro ligjit pa qenë i pranishëm jo vetëm në sallë, por as në Shqipëri. Me votën e socialistëve u vendos që votimi të quhet i vlefshëm, pasi nuk është konstatuar parregullsi. Nga këqyrja e pamjeve filmike të seancës së shkruar është vënë re se ashtu siç pretendon opozita është votuar edhe me kartën e deputetit Vangjel Tavo, i cili nuk ishte i pranishëm në sallë. Por kartën e tij të votimit duket se e ka përdorur deputeti Robert Bitri i larguar para pak kohësh nga LSI. Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, foli për një skenar pas këtij votimi. Ai tha se z.Bitri i kishin lënë kartën e Tavos në tavolinën e tij, me qëllim për të prishur votimin. Opozita në shenjë proteste bojkotoi seancën e djeshme plenare. Kurse kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi deklaroi: "Sekretariati i Procedurave të Votimit të Kuvendit të Shqipërisë, pasi zhvilloi mbledhjen për të shqyrtimin e kërkesës, në seancë dëgjimore thirri edhe deputetin Robert Bitri dhe Administratën e Kuvendit, dhe pas diskutimeve, me shumicë votash vendosi të rrëzojë kërkesën e paraqitur nga kryetarët e grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integritim. Së dyti, konstatoi të vlefshme procedurën e votimit të projektligjit në fjalë. Argumentet e Sekretariatit janë si vijon: Procedura e votimit është e saktë dhe e vlefshme, ky votim është i bazuar në



VOTIMI
Opozita pretendonte për manipulim dhe vjedhje votash. Por gjithçka lidhet me votimin e deputetit Robert Bitri me kartën e deputetit Vangjel Tavo. Vota e këtij të fundit u numërua pro ligjit pa qenë i pranishëm në sallë. Deputetja e LSI, Kejdi Mehmetaj duke i referuar ish-kolegut të LSI si rilindasi i vonuar tha se nuk ka pse të qëndrojnë më as formalisht në radhë me deputetët e LSI-së.

"Ndërroi kartën e Bitrit", Panariti, Ballës: Nxirr videon e plotë

Deputeti i LSI, Edmond Panariti iu kundërpërgjigj Taulant Ballës për videon që publikoi në rrjetet sociale. Panariti e fton Ballën që të publikojë të plotë videon e seancës. "Ptoj zotin Balla të publikojë të plotë videosekuencat e seancës dhe veçanërisht momentin kur zoti Bitri vjen në seancë edhe ulet në postin e tij. Aty do të shihni qartë se si zoti Bitri, pasi ulet në karrige, e largon kartën e deputetit Tavo dhe përdor kartën e tij. Vendosija e kartës së zotit Tavo në postin e z. Bitri ishte propozim për zëvendësimin e tij në formatin e grupit, pas largimit të tij nga LSI. Kjo është e vërteta", shprehet deputeti i LSI-së.

PD: Rama asgjësoi Kushtetuesen që të mos akimojmë "Teatrin"

PD-ja deklaroi dje se asgjësimi i Gjykatës Kushtetuese është pjesë e skemës mafioze të Edi Ramës për shembjen e Teatrit Kombëtar dhe ndërtimit të 6 kullave, duke grabitur tokën publike dhe private. Në një deklaratë për mediat, deputeti Enkelejd Alibeaj kërkoi nga faktori ndërkombëtar në Tiranë të reagojë për të ndaluar grabitjen e pasurisë publike dhe private nga kryeministri barbar dhe i korruptuar që drejton sot Shqipërinë, pasi sipas tij, gjithashtu ka përgjegjësi pse vendi është pa Gjykatë Kushtetuese. Për Alibeajn, skema mafioze nëpërmjet të cilës Edi Rama asgjësoi Gjykatën Kushtetuese dhe më pas miratoi me urgjencë ligjin antikushtetues të teatrit ka vetëm një qëllim: pastrimin e parave të pista të drogës dhe korrupsionit të Edi Ramës nëpërmjet shembjes së Teatrit Kombëtar, grabitjes së rreth 8500 metra katrorë pronë publike dhe kërcënimit të pronarëve privatë për ta shitur tokën me çmimin qesharak të përcaktuar, sërish në mënyrë antikushtetuese, nga kryemafiozi i qeverisë.



"Kompania 'Fusha' ndërtoi vilën e Ramës"

Paloka: PS vjedh votat, Balla votoi në emër të opozitës për prokuroren

Nën kryetari i PD-së, Edi Paloka akuzoi dje se kompania "Fusha", e cila do të ndërtojë godinën e teatrit të ri ka ndërtuar vilën e kryeministrit Rama në Surrë. Në "News 24" Paloka deklaroi se pronarëve të tokës po u bëhet presion, ndërsa tha se prona publike po merret në kundërshtim me ligjin. Po ashtu, Paloka përgëzoi publikisht për qëndrimin e tij ministrin e Diasporës, Paneli Majko, i cili gjatë seancës plenare kur u votua ligji për teatrin u largua dhe nuk mori pjesë në votim. "Kemi parë PS duke vjedhur votat e opozitës, kur Taulant Balla u kap me kamera duke votuar në emër të opozitës për prokuroren. Çdo deputet ka kartën e tij dhe kur e fut, më del emri Edi Paloka dhe jo Gramoz Ruçi. Është njësoj siç tha Rama, dhe verifikova unë përgjimin. Është një fakt, votimi është manipuluar. Pamjet tregojnë se u përdor karta e Tavos. Aty del që ka një votim parlamentar dhe i takon prokurorisë që të hetojë. Kemi 5 vjet me Ramën kryeministër që merrtet me këto përralla. Përgjimin s'ia mori përsipër t'ia bëjë Italia. Vetëm për këtë duhet të shkojë kryeministri para gjyqit. Në kemi kontakte me disa prej pronarëve afër teatrit dhe ata kanë thënë se nuk janë dakord t'ia japim kompanisë dhe kanë marrë kërcënime. Kompani 'Fusha' ka ndërtuar edhe vilën e Ramës. Po merret prona publike në kundërshtim me ligjin. Largimi i Majkos nga Kuvendi ishte për t'u përgëzuar. Unë e përgëzoj, pasi ai ishte i vetmi që s'e votoi ligjin për teatrin. Firma 'Fusha' ka lidhje mafioze dhe korruptive", theksoi z.Paloka.



Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit për Kuvendin dhe për Shumicën e Votimit. Votimi ka qenë i hapur, ka qenë me elektronikë dhe me ngritje dore sipas nenit 58 të Rregullores 'Për votimin në parim nën parën dhe në tërësi'. Asnjë deputeti të Kuvendit nuk i është

mohuar ushtrimi i së drejtës së votimit dhe shprehjes së vullnetit dhe rezultati i votimit nuk ka ndikuar dhe nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Kuvendit".
REAGIMI
Kreu i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho dhe

kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili reagues pas vendimit të Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet në Kuvend për rrëzimin e kërkesave të tyre që të anulohet votimi për Teatrin, sepse janë manipuluar votat. Spaho theksoi se mazhoranca përdor mekanizimin e votës për t'i hequr të drejtën e fjalës opozitës si në diktaturë. "Sekretariati për Procedurat dhe Votimet mori vendimin që pritej, mbështeti mazhorancën që votimi i ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar paska qenë i rregullt. Kjo në kushtet kur prova është e pakontestueshme që deputeti i mazhorancës, Bitri votoi në emër të deputetit Tavo. Me mekanizimin e votës vendosën sipas interesave të tyre në mbrojtje të aferës korruptive të Ramës dhe sulmit të egër të tij ndaj trashëgimisë kulturore dhe historike të Tiranës. Sa herë e kanë ndërruar të nevojshme, kanë përdorur mekanizimin e votës në Sekretariat, në Byro apo për t'i hequr të drejtën e fjalës opozitës në seance plenare. Lale Gramos o lale Gramos vetë shkruan, vetë vulos. Si në diktaturë", tha z.Spaho. Kurse kreu i grupit të LSI, Petrit Vasili këmbëngul që janë vjedhur votat për miratimin e ligjit për teatrin. "Hajdutët e votave refuzojnë e pengojnë rivotimin e ligjit për teatrin dhe vulosin manipulimin mu në mes të parlamentit të votimit të ligjit për teatrin. Vodiën teatrin, vjedhin votat edhe në parlament, vjedhin shqiptarët përditë me koncesione. Me një fjalë është epidemia hajdutësh në sytë e shqiptarëve dhe në krye të qeverisë. Dihet fundi i hajduteve...", tha Vasili.

Kush është sipas jush kryeministri më i suksesshëm? Kjo ishte pyetja e radhës e gazetares Eni Vasili, drejtuar ish-presidentit Alfred Moisiu në emisionin "Studio e Hapur". Ky i fundit u përgjigj se është e vështirë për të dhënë një emër, por gjithsesi ai zgjodhi kryeministrin aktual, Edi Rama.

Eni Vasili: Kush është sipas jush kryeministri më i suksesshëm?

Alferd Moisiu: Është e vështirë, sepse në periudha të ndryshme kanë qenë situata të ndryshme. Për shembull, procesi i llogaridhënies është gjë shumë e mirë, por kam frikë se mos është shumë formal. Ka

"Rrjeta e drejtësisë? Është, por jo për 'mizat e mëdha"

Ish-presidenti Alfred Moisiu: Rama, kryeministri më i mirë pas viteve '90

ministra që mua nuk ma kanë hapur telefonin dhe s'patën respekt jo vetëm që kam qenë ish-president, por edhe për moshën. Këto hallka kanë shtuar korrupsionin.

Eni Vasili: Mesa kuptova, Rama është më i suksesshmi?

Alfred Moisiu: Për mua Rama është më i miri pas '90-ës.

Teksa po komentonte luftën kundër krimit dhe korrupsionit në emisionin "Studio e Hapur", ish-presidenti Alfred Moisiu, ata që ambasadori Lu i quan "peshq të mëdhenj" i quajti "miza të mëdha". Sipas ish-presidentit, rrjeta mund të ketë, por jo për këta që ai i quan "miza të mëdha".

Eni Vasili: Ju i quani "miza të mëdha", ambasadori Lu i quan "peshq të mëdhenj". As miza, as peshq s'kemi parë.

Alfred Moisiu: Unë po përdor një shprehje të Balzakut. Rrjeta mund të jetë, por jo për 'mizat e mëdha'. Ish-presidenti Alfred Moisiu tha se politikanët shqetësohen se si të mbrojnë pasurinë që e kanë akumuluar në mënyrë abuzive. "Nuk është populli që i dik-



Ish-presidenti Alfred Moisiu

ton për mënyrën se si sillen politikanët, por militantët. Sepse shqiptarët nuk janë kështu, janë me shumë edukatë. Politikanët e kanë humbur respektin për njëri-tjetrin. Është për të ardhur keq. "Fshati" ka pushtuar të

gjithë politikën. Ne nga fshati kemi ardhur, s'e kam në këtë kuptim. Deri tani politikanët shqetësoheshin kush pasurohet, sot si të mbrojnë atë pasuri, që në mënyrë abuzive e kanë të akumuluar", tha ish-presidenti Moisiu.

Ministrat e Jashtëm të Procesit të Berlinit diskutojnë perspektivën evropiane të Ballkanit

Bushati në Samitin e Londrës: Forcim bashkëpunimit për sigurinë në rajon

Përfaqësuesit e BE, mbështetje për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtë me, Ditmir Bushati mori pjesë dje në takimin e ministrave të Jashtëm të vendeve të Procesit Berlinit, si pjesë e Samitit të Londrës kushtuar Ballkanit Perëndimor.

Çështjet kyçe që u trajtuuan gjatë takimit kishin të bënin me perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor, rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të rajonit si vlerë e shtuar ndaj sigurisë evropiane, adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë, rritjen e përkushtimit dhe hapjen e perspektivave ndaj gjeneratës së të rinjve si aseti më i madh i shoqërive të vendeve të rajonit, si dhe forcimin e angazhimeve të vendeve të rajonit ndaj demokracisë, sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ministri Bushati gjatë ndërhyrjes së tij vuri në dukje se forcimi i bashkëpunimit mes vendeve të rajonit dhe BE-së për çështjet e sigurisë, si në aspektin strategjik, ashtu edhe në atë operacional, është kusht thelbësor për forcimin e sigurisë rajonale dhe adresimin me sukses të sfidave të përbashkëta në këtë drejtim. "Vendet tona - vuri në dukje ai - përgjatë viteve të fundit kanë arritur një sukses të jashtëzakonshëm drejt vendosjes së paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit të ngushtë rajonal, arritje këto që janë bërë të mundura edhe falë perspektivës së përbashkët evropiane. Procesi i Berlinit - theksoi më tej ministri Bushati - ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në këto arritje, duke bërë të mundur nga ana tjetër edhe rritjen e një ndjesie 'pronësie' ndaj morisë së proceseve bashkëpunuese dhe integruese rajonale". Ndërkohë, ministri e Jashtëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe përfaqësuesit e lartë të



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtë, Ditmir Bushati, gjatë takimit të ministrave të Jashtëm në Londër

BE-së dhe Britanisë së Madhe si organizatorja e samitit, rikonfirmuan mbështetjen pa ekuivoqe ndaj avancimit të perspektivës evropiane të rajonit. Po ashtu, ata konfirmuan angazhimin e tyre

për të forcuar parimin e gjithëpërfshirjes, për zhvillimin dhe shndërrimin e Ballkanit Perëndimor në një rajon të qëndrueshëm dhe të sigurt, me mundësi të shtuara për zhvillim dhe

prosperitet ekonomik, si edhe për një mirëkuptim dhe gatishmëri të shtuar për zgjidhjen e çështjeve të hapura dypalëshe dhe tejkalimin e problemeve dhe trashëgimisë së të kaluarës.

Kryeministri Edi Rama ulet pranë homologut rus në ceremoninë e betimit të Erdoganit

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama janë takuar në Ankara, ku morën pjesë në ceremoninë e inaugurimit të presidentit turk, Taip Rexhep Erdogan. Liderët shqiptarë u ftuan nga presidenti turk, Erdogan. Pas inaugurimit, burimet mediatike folën për një takim të kryeministrit Rama me homologun e tij rus, Dimitri Medvedev. Por ata që e shoqërojnë kryeministrin thanë se mes tyre nuk ka pasur një takim, por vetëm janë ulur kraher njëri-tjetrit, sepse kështu ishte përcaktuar nga protokollit turk. Presidenti Rexhep Taip Erdogan u betua dje në një ceremoni madhështore. Pas 15 vitesh në pushtet, Erdogan u rivotua në krye të shtetit, ndërkohë që me nisjen e mandatit të tij të radhës, hyjnë në fuqi edhe ndryshimet kushtetuese, që e kthejnë Erdogan në një president ekzekutiv.



Xhafaj në Londër: Lufta kundër krimit, prioritet thelbësor



Lufta kundër krimit të organizuar është prioritet thelbësor i Shqipërisë. Kështu u shpreh ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj në Londër, ku mori pjesë në samitin për Ballkanin Perëndimor. Në këtë samit u mbajt një takim i parë i ministrave të Brendshëm të vendeve pjesëmarrëse të Procesit të Berlinit dhe Bullgarisë. Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj vlerë-

soi organizimin e Samitit, si një mundësi për të diskutuar dhe dakordësuar forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal. "Shqipëria e konsideron luftën kundër krimit të organizuar si prioritet thelbësor dhe për këtë është duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërinstucionale, e mishëruar në një Task Forcë Speciale, (e ngjashme me modelin Table Mate

në Mbretërinë e Bashkuar), e cila bën bashkë të gjitha agjencitë relevante brenda vendit, të ngarkuara me përgjegjësi ligjore në këtë drejtim. E parë në kontekstin e mësipërm, jemi duke thelluar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë britanikë, gjermanë, italianë, austriakë dhe agjencitë ligjbatuese të këtyre vendeve. Jo për shkak se ndodhem këtu në Londër, por bashkëpunimi

me autoritetet britanike dhe me NCA është një ndër model që ne duam të ndjekim në organizimin e strukturave tona në këtë fushë", u shpreh ministri Xhafaj. Ministri i Brendshëm evidentoi gjatë fjalës në samit, rezultatet e Task Forcës Speciale për identifikimin dhe arrestimin e një sërë grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë, përfshi edhe hetimin e aseteve të tyre. Ai shtoi se forcimi i sigurisë në Ballkan kërkon padyshim vijimin pa hezitim të procesit të integritetit evropian.

Dyshime se pas kushërinjve Vladi fshihet një grup i fuqishëm kriminal

Toyotat me 3.4 milionë euro, prokuroria dërgon letërporosi në Belgjikë, Gjermani dhe Angli

Kërkohet ndihmë nga ndërkombëtarët për Elvis e Alfred Vladin

Në kuadër të zhvillimit të hetimeve të nisura për kapjen dhe sekuestrimin e 3.4 milionë eurove në dy mjetet "Toyota Yaris" në Portin e Durrësit mesditën e 24 qershorit, Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkon ndihmën e tri shteteve europiane. Përmes tri letërporosive organi i akuzës u ka kërkuar informacion Belgjikës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, vende nga ku dyshohet se mund të jenë ngarkuar apo të kenë kaluar paratë. Në Belgjikë është dërguar informacioni për koncesionarin ku u blenë "Toyota". Prokurorët u kanë bërë kërkesë belgëve për çmimin e blerjes së automjeteve si dhe mënyrën e pagesës. Ndërkohë nga autoritetet gjermane Krimet e Rënda kërkojnë të dhëna për procedurën e plotësimit të deklaratave doganore të lëshuara nga koncesionari. Sa i përket Mbretërisë së Bashkuar, prokurorët e Krimeve të Rënda kërkojnë informacion në lidhje me dy kushërinjtë Elvis e Alfred Vladi të shpallur në kërkim si porositësit e eurove të padeklaruara, nëse ka procedime penale të mundshme ndaj tyre, apo mbi aktivitetet financiare të ligjshme a të paligjshme të tyre. Dy kushërinjtë, rezultojnë të jenë brenda territorit të vendit, sipas të dhënave të sistemit TMS, megjithatë kërkimet për kapjen e tyre nuk kanë dhënë rezultat. Dyshimet janë se ata mund të jenë larguar në mënyrë klandestine. Gjithashtu, dyshohet se pas kushërinjve Vladi fshihet një grup i fuqishëm kriminal. Aktualisht për këtë çështje janë arrestuar Agim Çeka, Edi Lika (Cani) dhe i biri, Klevi Lika (Cani) si dhe Alban Mollaymeri, të cilët janë lënë në masën "arrest në burg" nga Gjykata e Durrësit. Kujtojmë se fillimisht ky procedim u nis nga Akuzata e Durrësit, por më pas në



"Toyota" ku u sekuestruan eurot

LETËRPOROSITË

Përmes tri letërporosive organi i akuzës i ka kërkuar informacion Belgjikës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, vende nga ku dyshohet se mund të jenë ngarkuar apo të kenë kaluar paratë. Në Belgjikë është dërguar informacioni për koncesionarin ku u blenë "Toyota". Prokurorët u kanë bërë kërkesë belgëve për çmimin e blerjes së automjeteve si dhe mënyrën e pagesës.

kuadër të grupit të strukturuar kriminal hetimet u transferuan tek Krimet e Rënda. Me herët "Gazeta Shqiptare" siguroi dosjen e prokurorisë ku hidheshin dyshime se katër të akuzuarit dhe dy të shpallurit në kërkim kishin gjetur me këtë mënyrë një formë të pastrimit të parave të krimit. Në dosje tregohen rolet e secilit prej të akuzuarve si pjesë e këtij grupi të strukturuar kriminal. "Elvis Vladi ka dalë nga Shqipëria më 19.04.2018 dhe ka

shkuar në Belgjikë. Ai është marrë me organizimin e gjetjes së mjeteve për transportin e parave që vijnë nga aktivitetet kriminale dhe pasi është siguruar që ato po transportoheshin ka ardhur në Shqipëri me avion në datë 20 qershor 2018, pikërisht për të bërë pritjen e parave të pista. Nga ana tjetër, Edi Lika dhe Klevi Cani kanë marrë përsipër pjesën e parave të transportuar për portin e Durrësit ndërsa Al-

ban Mollaymeri do bënte zhdoganimin e tyre", sqarohet në dosjen e prokurorisë.

OPERACIONI

Në datë 24 qershor 2018, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti nga Belgjika një trajler tip "Bizarik" me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare, mbi bazën e porosisë së marrë në datë 20 qershor, ka bërë identifikimin dhe ndalimin e mjetit. Policia e Shtetit ka njoftuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila po drejton hetimet. Më tej, specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës në bashkëpunim me efektivet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e Prokurorisë, finalizuan operacionin dhe kryen veprimet procedurale.

Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit: Agim

Çeka, 61 vjeç, lindur në Luzi Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani), 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë; Klevi Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë; Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve: Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë; Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automjetin tip "Bizarik" të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevi Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuar në të, tip "Toyota" janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zvicerane, të padeklaruara. Gjithashtu janë ushtruar kontrole në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar. Janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 3.366.800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara; 80.000 franga zvicerane; 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit "Toyota Yaris", 1 tip "Alfa Romeo", 1 tip "Opel" dhe 1 tip "Bizarik"; 1 armë kalashnikov me 2 krehëra fishekë, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Çeka; 1 radio policie; 7 telefona celularë.

SHKURT

Vetingu, në "sitë" gjyqtari Admir Thanza, zbardhet pasuria

A nëtari i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza do të përballlet më 10 korrik me Komisionin e Paruar të Kualifikimit. Secanca dëgjimore është planifikuar të drejtohet nga Brunilda Bekteshi, me anëtarë Luzlim Hamitaj dhe Olsi Komici. Ai zotëron një pasuri familjare me vlerë rreth 50.5 milionë lekë, ndërkohe që të ardhurat kryesore rrjedhin nga aktiviteti i bashkëshortes si notere. Analiza e pasurisë është një ndër tre shtyllat e rivlerësimit për gjyqtarët, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. BIRN-i paraqet ndryshimin e pasurisë së deklaruar të gjyqtarit Admir Thanza nga viti 2003 deri në fund të vitit 2017. Të dhënat e analizuara nga BIRN tregojnë se gjyqtari Admir Thanza zotëronte një pasuri familjare me vlerë rreth 13.4 milionë lekë në vitin 2003-kur deklaroi për herë të parë pasurinë. Në fund të vitit 2017, vlera e pasurisë së deklaruar nga Thanza është rritur me tre herë, duke kapur vlerën e 50.5 milionë lekëve. Pasuritë e paluajtshme zënë pjesën kryesore me një vlerë të llogaritur në 27.5 milionë lekë, ndërkohe që llogaritë bankare të familjes Thanza kapin vlerën e 14.8 milionë lekëve. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zotëron gjithashtu 3.9 milionë lekë kurse me cash dhe automjete në vlerën e 2.3 milionë lekëve. Të ardhurat familjare të gjyqtarit Thanza kapin vlerën e 81.3 milionë lekëve për periudhën deklaruese, ku pjesën kryesore të tyre e zënë fitimet si notere të bashkëshortes së tij. Paga dhe shpërblimet nga funksioni i zotit Thanza zënë 28.5 për qind të të ardhurave totale të familjes, ndërkohe që 12 për qind e tyre ka si burim shifren e pasurive të paluajtshme. BIRN kreu kontrollin aritmetik/logjik për 14 vite të deklarimit të Z.Thanza, të cilat rezultojnë pa problem sa i përket raportit mes të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tentuan të trafikojnë kanabis drejt Italisë

Ngarkesa me 1.3 tonë drogë në Kavajë, prokuroria çon në gjyq 5 të pandehurit

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka çuar në gjyq dosjen në ngarkim të pesë të arrestuarve, Joni Sadikaj, Kejvi Hajdari, Nertil Shehu, Roland Hysenbelliu dhe Skerdi Sina, të cilët u kapën më 14 korrikut 2017, në fshatin Bago të Kavajës tek pastruesit të trafikimit 1.3 ton kanabis. Në përfundim të hetimeve, organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se të pesë të dyshuarit kanë kryer të gjitha veprimet për trafikimin drejt Italisë,

nëpërmjet detit të lëndës narkotike në sasinë prej 1359.1 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pikë një) kg, trafikim ky i cili nuk është realizuar si rezultat i ndërhyrjes të shërbimeve të policisë Kavajë. Kujtojmë se gjatë orëve të para të 14 korrikut 2017, nga efektivat e Komisarriatit të Policisë Kavajë, është zhvilluar operacioni i koduar "Pilotët". Operacioni u zhvillua në bazë të planit të masave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për goditjen e "Kultivimit" dhe "Trafikimit të

lëndëve narkotike", dhe konkretisht: Më datë 14.07.2017, rreth orës 02:20, shërbimet e policisë kanë marrë informacion se në vendin e quajtur fshati "Bago", dy automjete, konkretisht një "Land Rover" dhe një furgon mund të transportonin lëndë narkotike. Menjëherë është organizuar puna për bllokimin e tyre. Në momentin e kostatimit të këtyre dy automjeteve, nga ana e punonjësve të policisë u është bërë shenjë për të ndaluar, por këto automjete nuk kanë ndaluar duke shtuar shpe-



jëtisnin dhe duke rrezikuar jetën e punonjësve të policisë. Drejtuesit dhe personat e tjerë që kanë qenë në këto automjete, duke përfutur nga errësia dhe terreni i vështirë, kanë arritur të largohen duke braktisur autom-

jetet. Por, disa prej tyre u arrestuan më vonë. Nga këqyrja e këtyre automjeteve, rezultoi se në brendësi të tyre kishin pako të mëdha me lëndë të dyshuar narkotike kanabis, e cila pas peshimit rezultoi rreth 1360 kg.

RRITJA E PENSIONEVE INTERVISTA



Voltiza Duro

Eksperti: Pensionet para 2015-ës, përlogaritja e kompensimit të të ardhurave

Sabah Goci: Indeksimi i pensioneve me 2.8%, shtesa për 730 mijë persona

"Shtesa për çdo kategori, maksimumi 980 lekë"

P prej datës 1 korrik të këtij viti, rreth 730 mijë pensionistëve nga mbarë vendi iu lind e drejta të përfitojnë një rritje pensioni prej 2.8%, bazuar në vendimin më të fundit të qeverisë. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Sabah Goci, ekspert pensionesh, me një eksperiencë 21 vjeçare në ISSH tregon të gjitha kategoritë që do të përfitojnë nga rritja. Kështu rritjen do e përfitojnë të gjithë ata që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, familjar, nënat me shumë fëmijë si dhe ata që janë të përfshirë në skemën e trajtimit financiar të ushtarakëve; skemën e ish-punonjësve të nëntokës, praminorët; skemën e pensioneve suplementare të punonjësve të lartë të shtetit etj. Më tej, eksperti konkretizon nëpërmjet shembujve sesa do të jetë shtesa, bazuar në masën e pensionit të individit, bazuar në pensionet e llogaritura para dhe pas janarit të 2015-ës. Por eksperti ndërkohe thekson se kjo nuk është një rritje pensionesh, por një indeksim, një detyrim i Këshillit të Ministrave që mbrojnë pensionet nga ajo që quhet "gërryerja" e përditshme e inflacionit. Goci bën me dije për të gjithë të interesuarit që preken nga vendimi se shtesa minimale kap shifrën prej 369 lekësh të reja në muaj, ndërsa shtesa maksimale arrin në 980 lekë; kjo bazuar në masën e pensionit. Pra, sa më e madhe të jetë masa, aq më e lartë edhe shtesa e përfitur pas indeksimit me 2.8%.

Këshilli i Ministrave vendosi që pensionet të indeksohen me 2.8%. A është realizuar realisht ky indeksim?

Natyrisht pas votimit të vendimit të qeverisë mbi indeksimin e pensioneve; vetë realizimi i tij ka patur probleme teknike dhe organizative. Por dua të theksoj se prej datës 1 korrik të këtij viti, ashtu siç thuhej në vendim, të gjithë pensionistët e morën pensionin me rritje, pra me shtesën. Për këtë duhet përgëzuar veprimtaria dhe praktika e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Cfarë përfaqëson indeksimi i pensioneve me 2.8%, a?

Në gjuhën e përditshme kjo quhet rritje pensioni por realisht është indeksim, pra një detyrim i Këshillit të Ministrave për të indeksuar masën e pensioneve; të aty-



Sabah Goci, ekspert i pensioneve

369

LEKË TË RINJ SHTESA MINIMALE

"Nëse marrim një masë pensioni minimal të llogaritur para 1 janarit 2015, masa para indeksimit ishte 13563 lekë, ndërsa me aplikimin e rritjes, i bëhet një shtesë prej 369 lekësh, pra këtij pensioni minimal stok", - thekson Goci.

re që janë gjendje dhe të pensioneve të reja që priten të lidhen. Duhet të kuptohet se indeksimi është një tregues, një koeficient që mbrojnë pensionet nga ajo që quhet "gërryerja" e përditshme e inflacionit. Mendoj se ky indeksim me 2.8% ka qenë mbi nivelin e inflacionit. Por për të shkruar termi rritje duhet i referohemi mundësive financiare që ka buxheti i shtetit, pasi ky i fundit përbalton çdo ndryshim që bëhet në masën e pensioneve. Ky fond varion nga 1.8 miliardë lekë dhe është goxha i konsiderueshëm për skemën të tilla e buxhetete të tilla për Shqipërinë.

Sa është numri i individëve që do të përfitojnë nga shtesa e pensionit?

Vetëm numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit, të parakohshëm, të reduktuar, pra të përfshirë në skemën 7803, arrin në 630 mijë persona ku aplikohet vendimi i indeksimit të pensioneve. Por nga kjo rritje do të përfitojnë edhe rreth 100 mijë individë të përfshirë në skemat e tjera. Pra, në total, do

A marrin kompensim të ardhurash, pensionet e llogaritura para 1 janarit të vitit 2015-të?

980

LEKË TË RINJ, SHTESA MAKSIMALE

"Një masë pensioni prej 30000 lekësh pas indeksimit, shkon 30840 lekë, ndërsa ai pension prej 35000 lekësh do të shkojë 35980 lekë në muaj, pra ka një shtesë prej 980 lekësh", - bën me dije eksperti.

Por! Pensionet e llogaritura para vitit 2015-të, marrin edhe një kompensim të ardhurash. Ky kompensim përfaqëson përfundimin e pensionit minimal për ta çuar pranë pensionit mesatar, pasi ky i fundit në 2017-ën ishte 15527 lekë i realizuar nga pensionet e reja të lidhura. Po të marrim pensionin minimal prej 13000 lekësh, i

RRITJE APO INDEKSIM?

"Në gjuhën e përditshme kjo quhet rritje pensioni, por realisht është indeksim, pra një detyrim i Këshillit të Ministrave për të indeksuar masën e pensioneve; të atyre që janë gjendje dhe të pensioneve të reja që priten të lidhen", - thotë Goci.

shtohet kompensimi për ta përafërur me pensionin mesatar. Pra kompensimet e bëra me vendime specifike të Këshillit të Ministrave për të përafërur tendencën e pensionit minimal, pra për ta përafërur me pensionin mesatar janë të kësaj natyre.

A do të ndihet indeksimi prej 2.8% tek pensionet e përlogaritura pas janarit të vitit 2015?

Pas 1 janarit të 2015-ës, ka ndryshuar mënyra e llogaritjes së pensioneve, dhe ka bërë që të hiqet tavan i pensioneve në përlogaritje. Edhe kjo kategori pen-

KATEGORITË PËRFITUESE TË INDEKSIMIT ME 2.8%

- Pensionet afatgjata
- ◆ Përfituesit e pensioneve të pleqërisë
- ◆ Përfituesit e pensioneve të invaliditetit
- ◆ Përfituesit e pensioneve familjarë
- ◆ Përfituesit e pensioneve si nëna me shumë fëmijë
- Përfitues të skemës së sigurimit suplementar të ushtarakëve dhe policisë
- ◆ Përfituesit e pensioneve për vjetërsi shërbimi
- ◆ Përfituesit e pensioneve suplementare të ushtarakëve
- Përfitues të skemës së sigurimit shtetëror suplementar
- ◆ Përfitues të pagesës kalimtare
- ◆ Përfitues të pensioneve shtetërore suplementare
- Përfitues të skemës së trajtimeve të veçanta
- ◆ Statusi "Dëshmor i Atdheut"
- ◆ Për pilotët futururës në pension
- ◆ Për punonjësit e industrisë ushtarake
- ◆ Për punonjësit e nëntokës
- ◆ Për detarët e nëndetëseve në pension
- ◆ Statusi "profesor"

sionesh e ndjen rritjen pasi pëson rritje pensioni social. Nëse ky i fundit ka qenë 7100 lekë, ai pas indeksimit shkon rreth 7300 lekë dhe kur bashkohet me pjesën e llogaritur të pensionit jep influencën e vet. Pra 2.8% i indeksimit ndihet edhe për pensionet që do të lidhen pas korrikut

lehtë. Një masë pensioni prej 30000 lekësh pas indeksimit, shkon 30840 lekë, ndërsa ai pension prej 35000 lekësh do të shkojë 35980 lekë në muaj, pra ka një shtesë prej 980 lekësh.

Cilat janë kategoritë që përfitojnë nga rritja e pensioneve?

Të gjithë ata individë që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension për nënat me shumë fëmijë (të gjitha pensionet afatgjata që jep skema e sigurimeve shoqërore) e përfitojnë këtë indeksim prej 2.8%. Rritjen e pensionit e përfitojnë edhe disa skema si: skema trajtimit financiar të ushtarakëve; skema e ish-punonjësve të nëntokës, praminorët; skema e pensioneve suplementare të punonjësve të lartë të shtetit etj.

A ka ndonjë formulë mbi bazën e të cilës përlogaritjet rritja e pensioneve pas 1 korrikut?

Masa e rritjes është mbi masën e përfitimit, pra llogaritjet bëhen nëpërmjet indeksimit të thjeshtë aritmetik. Edhe këto skema janë të informatizuara pranë ISSH dhe shtesat janë marrë nga ana e pensionistëve prej 1 korrikut 2018.

Parashikohet ndërtimi i 20 shkollave të reja. Rikonstruktohen terrenet sportive e laboratorët

Përmirësohen kushtet e gjimnazit "Sami Frashëri" në kryeqytet

Erion Veliaj: Punime deri në zonat rurale

Pas përfundimit të vitit mësimor 2017-2018, në shkollat e kryeqytetit ka nisur puna për përmirësimin e kushteve në ambientet ku nxënësit do të rikthehen sërish pas pak muajsh. Kështu, krahas projektit për ndërtimin e 20 shkollave të reja, Bashkia e Tiranës po kujdeset që shkollat ekzistuese të përmirësojnë kushtet për të mirëpritur nxënësit e tyre. Një prej shkollave që iu nënshtrua rikonstruksionit është edhe gjimnazi "Sami Frashëri", nxënësit e të cilit mund të studiojnë në mjedise moderne. Bashkia e Tiranës, rikonstruktioi fushat sportive brenda dhe jashtë shkollës, sallat e zhveshjes, dyert e klasave, si dhe laboratorët shkencorë (biologji, kimi dhe informatikë).



edhe të 'Samiu' të vihej dorë, tha Veliaj. Ai deklaroi se Tirana është kthyer tashmë në një kanton ndërtimi, ku po punohet nga qendra deri në zonat rurale. Veliaj shprehu mirënjohjen për individët dhe kompanitë që tregojnë përgjegjësi të lartë sociale, duke kontribuar në realizimin e një sërë investimesh në dobi të komunitetit. "Jemi në një situatë ku Tirana është kthyer në një kanton pune, nga sheshi 'Skënderbej'

deri në fshatin më të largët. Në Tiranë kemi mbi 240 institucione arsimore, shkolla, kopshte, çerdhe, çka do të thotë se na duhet shumë mund dhe staf në terren, por ama kur kemi miq të përbashkët, kur i ndajmë disa përgjegjësi, na jep një kënaqësi shumë të veçantë. Ndaj, dua t'i falënderoj me gjithë zemër për ndihmën dhe bujarinë", deklaroi ai. Një vlerësim të veçantë, kreu i bashkisë shprehu për sta-

RIKONSTRUKTIVI

Një prej shkollave që iu nënshtrua rikonstruksionit është edhe gjimnazi "Sami Frashëri", nxënësit e të cilit mund të studiojnë në mjedise moderne. Bashkia e Tiranës, rikonstruktioi fushat sportive brenda dhe jashtë shkollës, sallat e zhveshjes, dyert e klasave, si dhe laboratorët shkencorë (biologji, kimi dhe informatikë).

fin pedagogjik, të cilët japin një kontribut të çmuar në edukimin dhe formimin e të rinjve të kryeqytetit. "Nuk ka një njeri që ta shënon jetën, siç ta shënon një mësues ose një mësuese e mirë, i cili mund të të lërë gjurmë, një kujtim që të frymëzon, që mund edhe të të kritikojë, por të jep aq shumë dobi në një moment kur t'i mendon se je i pakritikueshëm. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë mësuesit dhe mësueset", theksoi Veliaj.



Qendër e re shëndetësore në Maminas, Manastirliu: Nis puna për rindërtimin e 80 qendrave brenda 2018-ës


Një qendër e re shëndetësore i është shtuar Maminasit, si një model i qendrave të kujdesit parësor nga infrastruktura dhe shërbimi që ofron. "Është ndër qendrat më të mira të shërbimit parësor dhe është një shembull i mirë sesi bashkëpunimi i Ministrisë së Shëndetësisë me pushtetin vendor dhe biznesin, mund të sjellin rezultate të tilla në shërbim të komunitetit", u shpreh ministri Manastirliu gjatë vizitës në qendrën e re të Maminasit në Durrës. Duke shprehur angazhimin e qeverisë për përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës në shërbimin shëndetësor parësor, Manastirliu tha se ka nisur puna për rindërtimin e 80 qendrave shëndetësore në të gjithë vendin. "Vetëm në qarkun e Durrësit rehabilitohen 6 qendra shëndetësore këtë vit, në kuadër të programit kombëtar për rindërtimin e 300 qendrave shëndetësore në 4 vite, 80 prej të cilave rindërtohen këtë vit".

MANASTIRLIU

Vetëm në qarkun e Durrësit rehabilitohen 6 qendra shëndetësore këtë vit, në kuadër të programit kombëtar për rindërtimin e 300 qendrave shëndetësore në 4 vite, 80 prej të cilave rindërtohen këtë vit".

Vetëm në qarkun e Durrësit këtë vit rikonstruktohen Qendra Shëndetësore nr. 5, Qendra Shëndetësore nr. 6 në plazh, pika e ambulancës në Porto-Romano, pika e ambulancës në Shetaj (Ishëm), qendra shëndetësore Shënavlash (Rrashbull) dhe qendra shëndetësore Derede në Krulë. Brenda vitit përfundon rindërtimi i 80 qendrave shëndetësore në të gjithë vendin.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – the "RFP for Development of unified standard user-friendly websites for Albanian Municipalities." for STAR 2 Project

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 47903**

RFP for "RFP for Development of unified standard user-friendly websites for Albanian Municipalities." for STAR 2 Project

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 26 July 2018

Address for communications:
 Email: procurement.al@undp.org
 Or
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
 Tirana, Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT



TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 10.200.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **02 Gusht 2018, ora 10:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


Dyshohet se të ardhurat janë siguruar nga trafiku ndërkombëtar i drogës

"Forca e Ligjit", nis hetimi pasuror për fisin Çapja dhe të afërmit e tyre

Në "sitën" e verifikimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Task-Forcës, 13 persona

ELBASAN

ndërgjegjen gjatë rrugës dhe përpjekjet për ta reanimuar dështuan. Operacionet e shpëtimit bëhen më të komplikuar, ndërsa zhytësit po përpjekshin t'u mësonin fëmijëve teknika të ndry-

shme për të dalë nga shpella. Ka gjithmonë e më pak oksigjen në shpellë. Vdekja e zhytësit ngre dyshime serioze për sigurinë e përpjekjes për të nxjerrë 12 djentë dhe trajnerin e futbollit përmes



pasazheve të ngushta të shpellës së thellë, të mbuluar me ujë, në disa pjesë të rrugës mbi 2 kilometra. Shumë nga djentë, nga 11 deri në 16 vjeç, nuk dinë të notojnë dhe zhytësit po u mësojnë atyre bazat e zhytjes. Por pasazhet ku është e domosdoshme për t'u zhytur janë shumë të ngushta dhe fëmijët mund të duhet të notojnë vetëm dhe në errësirë në ujërat me baltë. Komandanti i marinës tajlandeze, i cili koordinon op-

eracionet, tha se shpëtuesit mund të kishin pak zgjedhje, duke pasur parasysh ardhjen e musoneve dhe faktin se në shpella po reduktohet oksigjenin. Duhet 11 orë për të shkuar dhe për t'u kthyer nga shpella. Duhet 11 orë për të bërë udhëtimin vajtërdhje, ndërmjet hyrjes në shpellën Tham Luang dhe pikës ku 12 futbollistët e rinj dhe trajneri i tyre janë bllokuar tashmë prej dymbëdhjetë ditësh. Nëse pje-

sa e parë lejon ecjen në këmbë në ujë, kilometri i fundit midis bazës së tretë të ndërmjetme, që shërben si një zonë pushimi dhe furnizimi për shpëtimtarët dhe djentë, përsëkohet për rreth tri orë.

Kërkohej një hyrje alternative

Nuk ka gjasa që e gjithë rruga të lirohet nga uji para fundjavës, kur priten shira të reja. Edhe për këtë arsye, jashtë shpellave, ekipet e tjera të shpëtimtarëve vazhdojnë të krehin khunglën në shpatet e malit, me shpresën për të gjetur një hyrje alternative nga e cila mund të nxirren djentë. Në orët e para të sinjalit të zhdokjes forcat zjarrfikëse arritën të hapnin një pjesë alternative në hyrjen kryesore. Problemi kryesor janë hartat e shpellës, e gjatë 10 kilometra. Të shtunën në mbremje forcat zjarrfikëse kanë çarë edhe një pjesë shkëmbi për t'i dhënë edhe mundësi ujit të dalë. Nëpërmjet vrimës së hapur në shpellë, policia u përpoq të hynte më në thellësi të saj.

"Presidenti i 81 milionëve", ja fjalët e të parit të vendit

Rexhep Taip Erdogan betohet pasi zgjidhet për herë të dytë, nis era e "sulltanit" në Turqi



Rexhep Taip Erdogan

Limuzina e presidenti të lëvizjedhur, Rexhep Taip Erdogan ishte e mbushur me trëndafila të hedhur përgjatë rrugës nga mijëra të pranishmit që e shoqëruan drejt parlamentit. Ai dje u betua për mandatin tij e dytë, që shenjon nisjen e një ere të re politike për vendin. Përpara deputetëve, presidenti turk shprehu përkushtimin e tij, duke bërë një fjalim gjithëpërfshirës. "Do të përpqem të jem i denjë për popullin tonë, me vetëdijen se jam presidenti i 81 milionëve, jo vetëm i atyre që na votuan. Populli ynë asnjëherë nuk na la vetëm, nuk na la në rrugë. Sistemi i ri presidencial i qeverisjes nuk është detyrim, por një preferencë drejt së cilës na ka orientuar historia". Pas betimit, presidenti Erdogan iu drejtua mauzoleut të Mustafa Kemal Atatürkut, ku vuri kurorë në kujtim të babait të Turqisë moderne. Rrugëtimi cere-

monial u ndal në stacionin e fundit, në pallatin presidencial në një ceremoni madhështore ku morën pjesë mbi 3 mijë të ftuar, 22 presidentë, 28 kryeministër dhe ish-drejtuës qeverish nga e gjithë bota. Të pranishëm ishin edhe kryeministri shqiptar Edi Rama, Presidenti i Kosovës Thaçi, ai

serb Vuçiq, shefi i qeverisë së Moskës Dimitri Medvedjev, ai hungarez Orban, e Presidenti i Venezuelës Nikolas Maduro. Ra në sy mungesa e disa prej liderëve perëndimorë që nuk figuruan në listën e pjesëmarrësve. Erdogan do të jetë i pari president që prej rënies së perandorisë

REXHEP TAIP ERDOGAN

"Do të përpqem të jem i denjë për popullin tonë, me vetëdijen se jam presidenti i 81 milionëve, jo vetëm i atyre që na votuan. Populli ynë asnjëherë nuk na la vetëm, nuk na la në rrugë. Sistemi i ri presidencial i qeverisjes nuk është detyrim, por një preferencë drejt së cilës na ka orientuar historia", ka thënë Erdogan.

osmane që do të ketë edhe kompetenca ekzekutive, me ndryshimet kushtetuese të vitit të kaluar, që shkruanë postin e kryeministrit

SHKURT

Londër, atentat me armë në mes të ditës

Një person i armatosur është filmuar nga kamerat e sigurisë teksa qëllon me armë ndaj një gruaje, e cila ndodhet brenda makinës së saj e bllokuar në trafik. I dyshuari i maskuar me kapuç, iu afrua makinës tip "BMW" dhe hapi zjarr duke qëlluar me pistoletë gruan 51-vjeçare që ndodhej brenda mjetit. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në pjesën veriore të Londrës, në 14 Maj, ndërsa pamjet janë bërë publike dje. Mrekullisht, gruajeja nuk pësoi asnjë lëndim. Ndërkohë, policia është duke e hetuar ngjarjen si vrasje e mbetur në tentativë. Sa i përket autorit, ende nuk ka asnjë person të dyshuar. Identifikimi i tij është i vështirë për shkak se ishte i maskuar.

Rumani, shkarkohet

kryeprokurorja e antikorrupsionit

Presidenti i Rumanisë shkarkoi ditën e djeshme kryeprokuroren e antikorrupsionit, Laura Codruta Kovesi, në zbatim të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Kovesi tha se vendimi mund t'i lërë prokurorët të zbuluar ndaj ndërhyrjeve politike. Ajo ka qenë në krye të agjencisë antikorrupsion që nga viti 2013 dhe nën drejtimin e saj, numri i dënimeve është rritur ndjeshëm në njërin prej vendeve më të korruptuar të Bashkimit Evropian, duke marrë përgjizime nga Brukseli, i cili e ka gjyqësorin rumun nën vëzhgim të posaçëm. Duke reaguar për vendimin, Kovesi fajësoi politikanët në pushtet se përpqen të bllokojnë funksionimin e gjyqësorit, duke zbuluar ligjet për krimin në parlament, për t'u mbrojtur nga ndjekjet penale. Vitet e fundit, prokurorët kanë siguruar një varg dënimesh kundër deputetëve, ministrave dhe kryebashkiakëve, nën akuzat për konflikte të interesit, shpërdorim pushteti, mashtrim dhe dhënie kontratash shtetërore në shkëmbim të rryshfetit.

Lajm i mirë nga Londra për Kosovën: Vendimi për vizat merret para pushimeve të verës

Johannes Hahn, komisioneri për zgjerim i BE-së, ka thënë se vendimi për liberalizim e vizave për Kosovën do të merret shumë shpejt. Ai ka premtuar se nuk do të ketë vonesa dhe shtyrje në këtë proces pasi do ta mbajnë premtimin dhe do ta marrin vendimin para pushimeve të verës. "Do ta mbajmë premtimin dhe

JOHANNES HAHN

"Nuk do të ketë vonesa dhe shtyrje në këtë proces, pasi do ta mbajnë premtimin dhe do ta marrin vendimin para pushimeve të verës.", - ka thënë Hahn për KTV. Ai po merr pjesë në Samitin BE-Balkan Perëndimor që ka nisur në Londër.

do të marrim vendim para pushimeve të verës", - ka thënë Hahn për KTV. Ai po

merr pjesë në Samitin BE-Balkan Perëndimor që ka nisur në Londër. Sot dhe

nesër në Londër mbahet Samiti Ekonomik në mes të BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Krahas liderëve të Ballkanit, Kosova po përfaqësohet nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe zv/kryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.



Braktisja e ushtrisë së Kosovës, kërcënoheshin me koktej molotovi

Largimi i serbëve nga FSK, Thaçi: Po zhvillojmë bisedime

Vuçiç: Veprimet kriminale s'do të përsëriten më

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka deklaruar se po zhvillohen bisedime me disa pjesëtarë serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës për kthimin e tyre në këtë Forcë, duke nënvizuar se askush nuk do të mund të pengojë formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Deklaratat e tij pasojnë largimin e disa pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si pasojë e presioneve të Beogradit. Në një bisedë me Radion 'Evropa e Lirë', presidenti Thaçi tha se Kosova insiston në paqe dhe raporte të mira fqinjësore. "Është koha për dorështrëngim dhe jo për t'u shikuar përmes tytave", -u shpreh Thaçi. Ai ka theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës është në rrugën e transformimit në ushtrinë e ardhshme të Kosovës. "Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë ushtri shumetnike, me standarde të NATO-s, gjithëpërfshirëse, në shërbim të paqes dhe stabilitetit. Do të jetë një ushtri me qëllim e vizion të sigurt për anëtarësim në NATO. Do të jetë një ushtri mbrojtëse dhe natyrisht me synimin për pjesëmarrje në misionet paqësore ndërkombëtare. Paraqet mesazhin e paqes dhe në asnjë rrethanë kërcënim për askënd", -theksoi Thaçi. Numri i pjesëtarëve serbë të FSK-së nga rajoni i Gjiçanit, javën e kaluar ka paraqitur kërkesën për largim nga kjo Forcë, për shkak të, siç është thënë, kërcënimeve dhe presioneve nga Beogradi. Koheve të fundit ata janë përballur me situata të pakëndshme, sulme me koktej molotovi ndaj pasurisë së tyre, ndalimeve gjatë kalimit kufitar në Serbi si dhe me kërcënimet e disa zyrtarëve në Beograd për dënimin e tyre deri në 10 vjet burgim, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në "formacionet e huaja të armatosura" (FSK). Presidenti Thaçi



ALEKSANDËR VUÇIÇ

"Nëse shihet si presion po që se themi që nuk do të dëshironim që serbi të shtinte në serbin, ngaqë për çdo gjë tjetër kjo ushtri do të shërbente. A do t'i lejojmë ata dhe ne të heshtim e të shikojmë qiellin derisa ata të na e vrasin popullin? Veprimet kriminale kundër popullit serb nuk do të përsëriten më", -ka thënë Vuçiç.

ka thënë se Forcat e Sigurisë së Kosovës po zhvillojnë konsultime, biseda të brendshme me pjesëtarët serbë të FSK-së rreth këtyre zhvillimeve, duke theksuar se askush nuk do të mund të ndalë transformimin e kësaj force në ushtrinë e Kosovës. "Duket që është një synim i organizuar. Tani për tani nuk mund të them që ka motiv të qartë politik, por autoritetet dhe zyrtarët, eproret e lartë të FSK-së janë duke i dëguar opinionet e

secilit veç e veç me mirëkuptimin më të madh që ata të vazhdojnë punën, të luajnë rolin e vet që u takon për vendin e vet. Tek e fundit Kosova është atdhe i të gjithë qytetarëve të saj. Por, një gjë mund ta them, askush as në Kosovë e as jashtë Kosovës nuk mund ta frenojë të drejtën e Kosovës si vend i pavarur e sovran që ta ketë ushtrinë e vet. Kjo punë tanimë është e kryer", -u shpreh presidenti Thaçi. Në anën tjetër, presidenti i Serbisë,

HASHIM THAÇI

"FSK do të jetë ushtri shumetnike, me standarde të NATO-s, gjithëpërfshirëse, në shërbim të paqes dhe stabilitetit. Do të jetë një ushtri me qëllim e vizion të sigurt për anëtarësim në NATO. Do të jetë një ushtri mbrojtëse dhe natyrisht me synimin për pjesëmarrje në misionet paqësore ndërkombëtare. Paraqet mesazhin e paqes dhe në asnjë rrethanë kërcënim për askënd", -theksoi Thaçi.

Aleksandar Vuçiç ka deklaruar të dielën se qëndrimi i tij është se serbët e Kosovës nuk duhet të marrin pjesë në Forcat e Armatosura të Kosovës. "Nëse shihet si presion po që se themi që nuk do të dëshironim që serbi të shtinte në serbin, ngase për çka tjetër kjo ushtri do të shërbente", -ka thënë Vuçiç, duke shtuar se kjo ushtri (e Kosovës) nuk do të sulmonte Shqipërinë, shqiptarët në Maqedoni apo ata në Mal të Zi. Duke potencuar se një ushtri e Kosovës mund të shihet vetëm kundër serbëve dhe Serbisë, Vuçiç ka deklaruar se nuk mund të shihet si presion kundërshtimi i Beogradit që serbët të jenë pjesë e FSK-së. "A do t'i lejojmë ata dhe ne të

heshtim e të shikojmë qiellin derisa ata të na e vrasin popullin", -ka thënë Vuçiç, duke përsëritur se veprimet, sipas tij "kriminale kundër popullit serb nuk do të përsëriten më". Ndërkohë, Thaçi ka thënë se Kosova nuk flet përmes armëve, por angazhohet për paqe, pajtim dhe raporte të mira me fqinjët. "Nuk dua t'i komentoj deklaratat që flasin për gjakderdhje, luftë apo shenjtërim të njëri-tjetrit. Koha është për shtrirjen e dorës së pajtimit dhe jo shikimit përmes tytës", -ka thënë Thaçi. Ai ka përsëritur se pret një marrëveshje me Serbinë në dialogun e Brukselit, e cila do t'u ndihmonte të dyja vendeve. Në qdo rrethanë, tha Thaçi, e ardhmja e Kosovës nuk është e lidhur me atë të Serbisë. "Po është shumë me rëndësi se derisa të mbërrim deri te ky moment duhet të sillemi në mënyrë korrekte me njëri-tjetrin, në mënyrë paqësore, ne hapa progresi dhe mirëkuptues ndaj njëri-tjetrit si dy shtete, por edhe si dy popuj", -theksoi Thaçi. Sipas tij, është me rëndësi jetike që të dyja shtetet të mos e befasojnë njëri-tjetrin. "Çdo pretendim për veto për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës do të jetë i dështuar", -theksoi presidenti Thaçi. Ai ka bërë të qartë se Kosova do t'i themelojë Forcat e Armatosura në partneritet dhe koordinim me NATO-n, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë.

DIALOGU



Aleksandër Vuçiç:

Asnjë propozim konkret për zgjidhjen e problemit kosovar për marrëveshjen

Aleksandar Vuçiç, presidenti i Serbisë, deklaroi se deri më tani nuk ka asnjë propozim për një zgjidhje të përhershme të problemit të Kosovës. Ai, gjithashtu, vuri në dukje se do të shkonte te njerëzit kur të kishte diçka për ta ofruar. "Çfarëdo që bëjmë, duhet të shkojmë në referendum. Çfarëdo që ndryshojmë dhe në çfarëdo mënyre, çfarëdo ndryshim kushtetues që duhet të bëjmë, duhet të shkojmë në një referendum", -tha Vuçiç për mediat në Zemun. Vuçiç tha se po përpigjet çdo ditë për të fituar diçka më të mirë dhe më shumë se ç'ishte më parë. "Në nivelin ditor, po përpigjemi të mbajmë diçka dhe të kemi diçka nga Kosova, shkruan 'Express'. Gjithkush, që më kritikon çdo ditë e di se sa kam të drejtë", tha Vuçiç dhe u kërkoi kundërshtarëve politikë që të mos e gënjejnë veten, as atë dhe as popullin për zgjidhjen e mundshme për Kosovën. Ai tha se nuk i bie ndërmend të thërrasë një referendum "nëse nuk ka asgjë më të rëndësishme se ajo që kanë sot". "Do të jetë shumë e vështirë rreth Kosovës. Më mirë është të arrihet një marrëveshje sesa mos të arrihet", tha ai. I pyetur për tërheqjen e serbëve nga Forca e Sigurisë së Kosovës, për të cilat zyrtarët e Prishtinës pretendojnë të jenë nën presion nga Beogradi, Vuçiç tha se qëndrimi i tij ishte se serbët nuk duhet të marrin pjesë në punën e tyre. "Ata thonë që ne bëjmë presion. Nëse them se nuk do të dëshironim që një serb të gjuante një serb, nëse kjo që po them është presion, ju mund ta quani atë siç të doni", -tha ai, duke shtuar se nuk do të ishte normale që një serb të gjuante një serb.

KU "Luarasi"

merr vlerësim maksimal për Akreditimin Institucional

Prof. Asoc. Dr. Stefan Qirici
Zv.Rektor për Procesin Akademik

Në vitin akademik 2016-2017 pothuajse të gjitha IAL-të publike dhe private kaluan në procesin e akreditimit institucional. Për herë të parë në këtë proces krahas Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL-it) u angazhua edhe Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (QAA). Ekipi i ekspertëve të jashtëm që do të realizonte Akreditimin Institucional të KU "Luarasit" përbëhej tre ekspertë prej të cilëve, dy u zgjodhën nga Agjencia Britanike QAA, Ms. Penny Renwick, që ishte njëkohësisht edhe drejtuesi i ekipit; Prof. Jeremy Bradshaw, anëtar dhe një eksperte, Dr. Diturije Ismaili, u zgjodhën nga ASCAL-i, anëtare.

Qëllimi final i këtij procesi ishte të vlerësohej se në çfarë mase KU "Luarasi" i përmbushte Standardet Shtetërore të Cilësisë të Arsimit të lartë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Për të bërë këtë vlerësim, Standardet Shtetërore të Cilësisë u grupuan në pesë fusha: 1. Organizimi dhe menaxhimi; 2. Burimet; 3. Kurrikula; 4. Mësimdhënia, mësimnxënja, vlerësimi dhe kërkimi shkencor; 5. Studentët dhe mbështetja e tyre.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), e cila funksionon si strukturë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në KU "Luarasi", me përgjegjësi dhe me profesionalizëm të lartë i menaxhoi dhe i realizoi me sukses të gjitha fazat nëpër të cilat kaloi procesi i akreditimit institucional. Ajo hartoi Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, grumbulloi të gjithë bazën e të dhënave sasiore dhe cilësore, përgatiti të gjitha evidencat dëshmuuese, të cilat i dorëzoi në ASCAL brenda afatëve kohore të përcaktuara.

Ekipi i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, bazuar në informacionin e dërguar nga KU "Luarasi" dhe në vizitën dyditore të realizuar në institucionin tonë hartoi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë. Bazuar në këtë raport, Bordi i Akreditimit i ASCAL-it konstatoi se:

"Rezultatet e vlerësimit të jashtëm në lidhje me shkallën e plotësisht të Standardet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë sipas fushave për KU "Luarasin" janë:

Fusha 1: "Përmbushen plotësisht", kjo do të thotë se, KU "Luarasi" ka një strukturë organizative akademike të përshtatshme, që funksionon në mënyrë efektive dhe menaxhohet me cilësi të lartë. Ato udhëhiqen nga planet strategjike dhe vjetore, vendosin objektiva dhe synojnë realizimin e tyre në sasi dhe në cilësi.

Fusha 2: "Përmbushen plotësisht", kjo do të thotë se, KU "Luarasi", i mbështetur fuqimisht nga "Hysenbelliu Grup" zotëron burimet e veta njerëzore, materiale dhe financiare, të cilat garantojnë një proces normal të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me parametra cilësore.

Fusha 3: "Përmbushen plotësisht", kjo do të thotë se, kurrikulat që ofron KU "Luarasi" në programet e studimit "Bachelor" dhe "Master" janë bashkëkohore, janë të hartuara duke u bazuar në eksperiencën dhe praktikën më të mira dhe i japin studentit njohuri, aftësi dhe kompetenca për të qenë të aftë dhe konkurruese në tregun e punës.

Fusha 4: "Përmbushen plotësisht", kjo do të thotë se, mësimdhënia dhe mësimnxënja janë në nivel të lartë cilësor, që garantohej nga niveli cilësor i stafit akademik, i cili është i motivuar, i përkushtuar dhe i mirëvlerësuar. Gjithashtu, kërkimi shkencor, në të cilin përfshihet stafi akademik, është në funksion dhe i shërben mësimdhënies cilësore në auditore.

Fusha 5: "Përmbushen plotësisht", kjo do të thotë se, studentët tanë i përmbushin

plotësisht prirshmëritë e tyre. Janë të kënaqur me shërbimin që u ofrohet dhe rezultojnë se ata kanë bërë zgjedhjen më të mirë që studiojnë në KU "Luarasi" për profesionin e tyre të ardhshëm. Filozofia jonë është dhe mbetet: "Studenti në qendër të vëmendjes!"

Bazuar në këto konstatime dhe rekomandime të Ekipit të Ekspertëve të Jashtëm të Cilësisë, Bordi i Akreditimit me Vendimin Nr.115, datë 15.12.2017, vendosi:

1. Vlerësimin përfundimtar pozitiv për institucionin e Arsimit të Lartë, KU "Luarasi".

2. Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, KU "Luarasi" me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit të Institucionit është: 14.12.2023

KU "Luarasi" duke marrë këtë vlerësim maksimal nga ndërkombëtarët rezultojnë se, ai jo vetëm i përmbush të gjitha standardet e arsimit të lartë në Shqipëri, por në të njëjtën kohë garanton qëndrueshmëri në cilësi dhe përmirësim të vazhdueshëm të saj. Natyrisht, kjo është një arritje madhe që i dedikohet angazhimit total të pronarit të KU "Luarasit", autoriteteve drejtuese akademike të tij, pedagogëve, studentëve, studentëve alumni dhe stafit ndihmës administrativ.

Ky vlerësim maksimal është njëkohësisht edhe një përmbushje dhe mbajtje e premtimit ndaj detyrimeve që kemi ndaj studentëve tanë dhe prindërve që na kanë besuar edukimin e fëmijëve të tyre. KU "Luarasi" synon të ketë programe mësimore në fushën e drejtësisë, të ekonomisë dhe të

teknologjisë së informacionit sa më cilësore, nëpërmjet të cilëve studentët pajisen me njohuri, aftësi, kompetenca bashkëkohore, të cilat i bëjnë ata konkurrentë të suksesshëm në tregun e punës.

Vlerësimi maksimal që mori KU "Luarasi" nga ndërkombëtarët është një argument i fuqishëm pse maturantët, studentët e rinj dhe prindërit e tyre duhet të zgjedhin dhe t'i besojnë të ardhmen e profesionit të tyre KU "Luarasit".

Vlerësimi maksimal nga ndërkombëtarët në akreditimin Institucional për KU "Luarasin" na bën krenarë për arritjet e deritanishme, por njëkohësisht edhe na obligon me përgjegjësi akoma më të madha për të ardhmen. Në Samitin e Berlinit u theksua se: "Përgjegjësia parësore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë qëndron te secili institucion dhe kjo përbën bazën e

derojmë institucionin tonë të përsosur, atëherë ai nuk ka të ardhme!"

Është kjo arsyeja që, në KU "Luarasi", duke u udhëhequr nga filozofia se, "Studenti është në qendër të vëmendjes", sigurimi i vazhdueshëm i brendshëm i cilësisë është konsideruar dhe konsiderohet si një ndër faktorët më të rëndësishëm, themelor, i cili garanton se në vazhdimësi ka përmirësim në rritje dhe në zhvillim në të gjithë veprimtarinë e tij në fushën mësimore, edukative dhe shkencore.

Gjithashtu, nëpërmjet sigurimit të vazhdueshëm, të brendshëm të cilësisë, ne synojmë t'u bashkëngjitemi tendencave të zhvillimeve të sotme të hapësirën europiane të arsimit të lartë, që starton me Marrëveshjen e Bolonjës. Cilësia është një koncept kompleks dhe relativisht i vështirë për t'u matur, megjithatë, në konceptimin tonë, kur flasim për cilësinë, kemi parasysh dy aspekte kryesore:

1. Sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë, që fokusohet kryesisht në problemet apo çështjet akademike, që lidhen ngushtësisht me përmbushjen e standardeve shtetërore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor me të gjitha shërbimet që mbështesin studentin në tërësinë e aktiviteteve mësimore dhe shkencore.

2. Menaxhimi i cilësisë që fokusohet kryesisht në hartimin, zbatimin, monitorimin e politikave dhe procedurave nga lidhshipi i KU "Luarasit", të cilat paraqesin përmbushjen e standardeve shtetërore lidhur me cilësinë e drejtimit akademik dhe administrativ në krijimin e të gjitha kushteve për arritjen e sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë.

Jemi të vetëdijshëm se sigurimi i brendshëm i cilësisë përmirësohet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm të vetëvlerësimit duke ballafaquar objektivat dhe standardet me arritjet aktuale, duke analizuar dhe vlerësuar progresin e realizuar në dinamikë dhe duke përcaktuar planin e veprimeve të ardhshme.

Cilësia e menaxhimit arrihet dhe përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme kur politikat, procedurat, procesi i aplikimit dhe monitorimit të tyre në praktikë bëhet i njohur për të gjitha palët e interesuara.

Synimi është që gjithsecili nga palët e interesuara në KU "Luarasi", studentët, p e d a g o g e t, prindërit, studentët alumni, stafi ndihmës të krijojnë sinergji dhe të përfshihen në krijimin dhe zhvillimin e kulturës së cilësisë. Garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë është dhe do të mbetet përgjegjësia kryesore e KU "Luarasit" në mësimdhënie, mësimnxënje dhe kërkimin shkencor dhe aktivitetet të tjera jashtë auditorit, duke e vendosur "Studentin në qendër të vëmendjes".



përgjegjshmërisë brenda kornizave të cilësisë kombëtare".

KU "Luarasi" me Certifikatën e Akreditimit Institucional për periudhën gjashtëvjeçare (2017-2023) nuk e shikon këtë si një arritje të castit, por si një garanci dhe bazë të fuqishme për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ne i përmbahemi filozofisë se, "në qoftë se sot e konsi-

TEATRI

Disa opinione mbi absurditetin e prishjes së Teatrit Kombëtar

Nga Edmond Hali*

P hedh disa opinione të mia në lidhje me debatin për Teatrin Kombëtar, pasi më duket e pa vend që komuniteti ynë i arkitektëve dhe urbanistëve është kaq i tërhequr në këto opinione. Inxhinieria është një shkencë e saktë dhe shumë kokëfortë për sa i përket numrave! Pyetja e parë që lind tek të gjithë është: A kemi nevojë për një Teatër Kombëtar dinjitoz? Përgjigja është e thjeshtë. Poool!

A i përbush godina ekzistuese kushtet për të? Përgjigja është e thjeshtë. Joool! Pra, është e qartë se duhet një teatër i ri për një kryeqytet si Tirana. Në fakt, për këto pyetje përgjigjet janë të unifikuara tek të gjithë. Ajo që i ndan palët është se si të arrihet të ky objektivi. Diskutohet për fonde, të cilat, sipas një pale propozuese janë rreth 30mln euro. Shteti shqiptar: në kushtet e problematikave buxhetore është i prirur që këtë shumë ta kanalizojë tek Teatri i Ri përmes këtij privati, në këmbim të dhënies së një pa-surie publike. Pra, një marrëdhënie tipike pronar-investitor: Në fund të shkëmbimit të dy palët dalin të fituara. Më poshtë do të zhvilloj shkurtazat një ushtrim që tregon fare qartë se pse NUK ËSHTË E DOMOSDOSHME prishja e Teatrit Kombëtar!

Me një llogaritje të thjeshtë, që investitori privat të jetë i interesuar për këtë, duhet që

pjesa që i takon pronarit të trullallit të jetë sa vlera e investimit që do të kalojë për teatrin e ri.

Pra, shtetit i duhet të marrë një sipërfaqe objekti me vlerë 30 mln euro. Me çmimin aktual, supozohet që vlera e shitjes për 1 m2 objekt në zonë të jetë rreth 3000 euro. Pra, duhet që investitori duhet të japë tek pronarët e truallit rreth 10.000 m2 objekt të ri.

Me shitjen e këtyre metrave katrorë nga investitori sigurohen minimalisht 30 mln eurot e nevojshme për ndërtimin e teatrit të ri.

Marrim përqindjen e mundshme që mund të arrihet në këtë rast, e cila është 50%. Shifra nuk është e fryrë dhe pala private (shumë nga ndërtuesit në Shqipëri) pranon me këto kushte për shkak

të pozicionit fantastik kundohet truallit. Pra, duhet që në truallin në fjalë të ndërtohen minimalisht rreth 20.000 m2 objekt i ri. Nëse ndërtimi i ri do të jetë rreth 20 kate (në rastin e kullave), i bie që sipërfaqja e kati të një kulle të jetë rreth 1000 m2 (Në ilustrimin më poshtë është paraqitur një kullë me sipërfaqe kati prej 1200 m2).

Nga informacionet që kemi, pjesa e Bashkisë është 2100 m2 dhe pjesa e privatit diku tek 1000 m2. Duke qenë se objekti ekzistues shumëkatesh është kaillkan nga ana e teatrit, nga ana teknike (rast i ngjashëm është kulla 22 kate përballë Kishës Ortodokse) aty ekziston mundësia e ndërtimit të një kulle me sipërfaqe kati

rreth 1200 m2. Për orientim, kulla "Torre Drini" ka një sipërfaqe kati rreth 870 m2. Pra, objekti i ri do të ishte një kullë me një sipërfaqe kati pak më të madhe. Për interesa madhore publike, pa shkelur interesat e të tretëve, aty mund të miratohet ndërtimi i një objekti i cili është mbi 24.000 m2 (mbi tokë) ndërtim në total. Pra, ndërtohet një kullë e re dhe ruhen të paktën Teatri Kombëtar dhe banesa e Toptanëve si objekt i trashëgimisë kulturore. Ky ushtrim është thjesht aritmetik dhe nuk merr përsipër që të debatohet mbi komponentet arkitektonike dhe urbanistike të objektit të ri. Gjithashtu, nuk i jep përgjigje pjesës etike dhe ligjore mbi mundësinë e përdorimit të pronës publike

Arkitekti: Sasia e objekteve të vjetra në Tiranë është aq e vogël sa të merr vaji



për këtë qëllim. Duke parë tendencën dhe aprovimin në parim të shtetarëve për objektin (objektet) e preztuar përkras teatrit të ri të projektuar, mendoj se një kullë rreth 20-25 kate është ku e ku më mirë se një 5-6 struktura bashkëgjitur, porë kjo nga pikëpamja Urbanistike dhe Arkitekturore.

• Nuk ka nevojë REALE që të prishet godina ekzistuese e Teatrit Kombëtar;

• Arsyetja e vërtetë për prishjen e tij nuk është ekonomike;

• Shteti mund të përfitojë rreth 30 mln euro duke dhënë një leje të sforcuar, pa marrë parasysh kriteret e intensitetit apo lartësisë dhe koeficientit e shfrytëzimit të territorit, në këmbim të një vepre madhore siç është Teatri i ri Kombëtar;

• Trualli i teatrit ekzistues mbetet i paprekur së bashku me godinat, duke realizuar një kërkesë të shumë faktorëve që janë pronuarur deri tani;

• Investitori do të ndërtojë dhe të realizojë prishmëritë e tij ekonomike, duke i dhënë qytetit mjetet financiare për një teatër të ri;

• Vetëm me kursimin e një fondi kontigjence prej 5% (1.5 mln euro) që do të caktohet gjatë ndërtimit të teatrit të ri mund të realizohet një rikonstruksion i cili do ta mbajë në jetë godinën për shumë e shumë vite të tjera;

• Të gjithë palët dalin nga llogoret respektive pa pasur nevojë ta çojnë betejën tek përdorimi i "armëve".

I gjithë ushtrimi i mësipërm vlen për të ngritur disa pyetje të thjeshta:

1. Pse duhet të prishet me patjetër Teatri?
2. Ku qëndron domosdoshmëria e prishjes së këtij objekti historik?
3. A pranon një investitor privat këtë formulë PPP, e cila është e mirënjohur?
4. A duhet të miratohet një Leje Ndërtimi për këtë strukturë të re?
5. A do të funksionojë mekanizmi PPP në këtë rast?

Në vazhdim dua të jap argumentet e mia se përse NUK DUHET PRISHUR teatri ekzistues:

• Qyteti dhe arkitektura në përgjithësi ekzistojnë si të tilla kryesisht për shkak të historisë, e cila krijohet me

shumë mund. Pak a shumë është si puna e atij prodhuesit të verës që i reziston tundimit për ta pirë apo shitur atë me dëshirën për ta vjetruar dhe vlerësuar sa më shumë. Lënda e parë që çdo student i arkitekturës studion në fakultet quhet "Histori e Arkitekturës".

• Objekti ka një histori fantastike të tij që fillon nga koha e mbretërisë, fashizmit, më tej komunizmit dhe aktualisht demokracisë. Është një muze i gjallë që, edhe po të mos ekzistonte, duhej sajuar disi. Aty janë gjurmët e të gjithë hapave të shtetit shqiptar; Përpjekjet e mbretërisë për të krijuar elitat, janë bërë gjyqet e famshme të antikomunistëve shqiptarë; janë krijuar institucionet e Cirkut, Baletit, Teatrit Kombëtar dhe jam i sigurt që nuk kam përmendur plot gjëra të tjera;

• Në Tiranë janë ruajtur objekte pa asnjë lloj vlerë arkitektonike, përveç vlerës thjesht historike, siç janë Xhamia e qendrës, Tymbja (varri) i Kapllan Pashës, Teatri i Kullave (ish-Parlamenti i parë shqiptar), Ura e Tabakëve etj. U anulua rruqa që do të realizohej aty ku sot është pedonalja, sepse dolën disa gurë masivë të cilët kanë vetëm një vlerë... Historinë. Ka shembuj të tjerë të tillë nëpër Shqipëri që gjithsej i di;

• Sasia e objekteve të vjetra në Tiranë është aq e vogël sa të merr vaji. Historia e saj është aq e pa dokumentuar dhe e varfër, sa çdo prishje e objekteve të vjetra me një farë historie dhe rëndësie do të duhej të mendohej nga administratorët e qytetit shumë shumë gjatë dhe vetëm për qëllime madhore.

KONKLUSION

Tirana dhe e gjithë Shqipëria meritojnë një Teatër të ri Kombëtar.

Ai mund të ndërtohet me paratë e investitorit që është vetëofruar përgjatë bulevardit qendror të Tiranës në shumë vende.

Për të qenë më konkret po propozoj disa:

- Parku Rinia,
 - Lulishtja e Vëllëzëve Frashëri,
 - Lulishtja përballë hotel "Rogner",
 - Lulishtja përgjatë shtesës së bulevardit të ri të Tiranës.
- Të gjithë këto vende janë dinjitozë mjaftueshëm për një Teatër të ri Kombëtar.

*Arkitekt

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit: Marshojmë drejt Kryeministrit



cili nuk rrezikon thjesht godinat dhe pronën publike, por sistemin demokratik në tërësi. E megjithatë parlamenti, ditën e enjte, vendosi të injorojë zërat e shqiptarëve dhe të miratojë një ligj të posaçëm, i cili ia merr tokën publike Teatrit dhe ia jep kompanisë Fusha shpk për të ndërtuar kulla, ia merr

Teatrin Kombëtar shqiptarëve, me gjithë vlerat historike dhe arkitektonike të tij, për të përbushur nevojat financiare të një grushti të vogël personash", - shënon Aleanca. Vëren se parlamenti vendosi të injorojë shumicën e shqiptarëve dhe të degojë vetëm një njeri. Për ta, "KJO NUK ËSHTË

DEMOKRACI! KJO ËSHTË DIKTATURË!"

Për sa më lart, "ditën e enjte, bashkohemi në orën 18:30 të sheshi i Teatrit për të marshuar me pas drejt Kryeministrit dhe Presidencës, së bashku me qindra artistë, intelektualë dhe aktivistë, për t'i treguar grushtit të vogël të njerëzve me pushtet se në Shqipëri ka ende njerëz të lirë. Për t'i kërkuar Kryeministrit të tërhiqet dhe Presidentit të kthejë mbrapsht Ligjin e turpshëm të miratuar ditën e enjte nga Parlamenti. Ne jemi njerëz të lirë! Ne jemi Teatri!"

"Bashkohu!", është thirrja që bën Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit.

Prejt 5 muajsh, mijëra qytetarë kanë ngritur zërin kundër shembjes së Teatrit Kombëtar. Mijëra qytetarë u janë bashkuar protestave të përditshme kundër asaj që konsiderohet vjedhje e pronës publike në favor të një firme ndërtimi dhe shndërrimit të historisë në një shesh ndërtimi, thotë Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, duke shtuar se dhjetëra mijëra janë bashkuar online dhe kanë ngritur zërin nëpërmjet peticioneve dhe rrjetëve sociale kundër të pangopurve. "Qindra artistë kanë kundërshtuar shkatërrimin e trashëgimisë historike dhe shpirtërore. Qindra arkitektë kanë kundërshtuar atë që ata e quajnë një projekt të turpshëm dhe simbol të babëzisë. Qindra intelektualë kanë ngritur zërin kundër këtij akti, i

Opinion i Ditës

Majko, dëshmitari i fundit i një PS-je që ka vdekur

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... akt burrërie, fisnikërie dhe koherence politike. Ai nuk qe gjithashtu vetëm mbajtja e një premtimi që ish-shefi qeverisë në vitin e largët '99 u kishte dhënë artistëve. Më shumë se gjithçka, ajo që Pandeli Majko bëri të entjen që shkoi në parlament, qe një requiem për një PS që tashmë ka dhënë shpirt.

Si një nga anëtarët më të vjetër të kësaj partie, Majko e mban mend formacionin, që megjithëse i mbushur me punistë, u hapi dyert dy pjesëtarëve të studentëve të dhjetorit, atij dhe Ilir Metës. Ai e kujton mirë se organizata rinore që themeloi, FRESH-i, ishte ëndërrimtarja e parë e një Shqipërie në NATO, atëherë kur shumica e konservatorëve në PS e konsideronin këtë gjë si sakrilegj.

Ai i ka të ngulitura në kujtesë sekuenat e mocionit epik të '96, kur kryetari i burgosur Nano, konkurronte në bllok me gjithë establishmentin e atrofizuar të partisë.

Ai i ruan në memorie hapat e parë të qeverisë së pas '97-ës, ku megjithëse kishin një stërmazhorancë votash, socialistët e ndanë drejtimin e vendit me anëtarë të spikatur të koalicionit nën moton: "Të sakrifikojmë pushtet për të bërë shtet".

Natyrisht, Pandeli Majko nuk ka se si të harrojë se si kjo parti kolegjiale, e hapur dhe tolerante, ndëshkoi gafat e dy kryeministrave të zgjedhur prej saj, Nanos dhe Metës për t'i hapur atij vetë rrugën e drejtimin të vendit. Po ashtu, besoj se nuk është bërë pishman, që do të mbahet mend si i vetmi kryeministër i Shqipërisë, që ka humbur për një grusht votash garën brenda partisë (kongresi i dhjetorit të 1999), duke refuzuar plot dinjitet të përdorte armët okulte që të ofron pushteti.

Pikërisht, këtë PS, që sot mund të duket si ëndërr, trashëgoi Edi Rama në vjeshtë-dimrin e 2005-ës. Një parti që i dha atij mandatin e kryetarit, por duke i rrëzuar me një maturi dhe sens të pakrah-sueshëm ekuilibri, platformën që paraqiti. Një parti ku lulëzonin të gjitha lulet, ku bashkëjetonin të gjitha rrymat dhe ku ata që kishin mbetur në minorancë në mbrojtje të një ideje, prisnin radhën sipas lojës së magjishme të politikës të bëheshin shumicë në të ardhmen.

Mjaftuan pak vite që kryeministri aktual ta përdhoste këtë pasuri që i kishte siguruar dhe vendit një drejtpeshim të mahnitshëm: sa herë që Shqipëria rrezikonte të rrëshqiste në autoritarizëm, qytetarët i besonin PS-së



Si një nga anëtarët më të vjetër të kësaj partie, Majko e mban mend formacionin, që megjithëse i mbushur me punistë, u hapi dyert dy pjesëtarëve të studentëve të dhjetorit, atij dhe Ilir Metës. Ai e kujton mirë se organizata rinore që themeloi, FRESH-i, ishte ëndërrimtarja e parë e një Shqipërie në NATO, atëherë kur shumica e konservatorëve në PS e konsideronin këtë gjë si sakrilegj.

rivendosjen e balancave.

Në një kohë të shkurtër, garat epike Nano-Majko për kryetar u zëvendësuan nga farsat qesharake Rama-Lakrori. Nga statuti u zhduk nën për dorëheqjen e liderit që e shpie partinë në humbje. Konkurrenca u zhduk deri sa në fund degradoi në modelet Kimjong Un-janë të kryetarit të përjetshëm. Brenda PS, ashtu siç thoshte Blushi, të gjithë filluan t'i përshtaten devizës: "Mos i fol shoferit". Të tërë ulën kokën pa bërë zë kur parlamenti u mbush me burra që vinin direkt nga krimi dhe me gra të dhunuara, merita e vetme të të cilave qe idhujtaria ndaj shefit.

Pikërisht, ky model që ne e njohim paradoksalisht me emrin Rilindje votoi pak ditë më parë për prishjen e Teatrit Kombëtar. Kokulur, të pëshitur, servilë deri në neveri dhe trutharë deri në krenari, ata iu bindën delirrit kleptokratik të shefit të tyre.

Natyrisht, Pandeli Majko nuk ka se si të harrojë se si kjo parti kolegjiale, e hapur dhe tolerante, ndëshkoi gafat e dy kryeministrave të zgjedhur prej saj, Nanos dhe Metës për t'i hapur atij vetë rrugën e drejtimin të vendit.

Ndryshe nga ata, Pandeli Majko nuk mund të mbërrinte deri këtu. Dy herë kryeministër, deputet që është shqetësuar ndryshe nga të parët për imazhin e tij publik, me profilin e një politikani të pakorruptuar dhe që shpesh e ka vuajtur koherencën ndaj bindjeve të veta (mbeti jashtë qeverisë në 2013-ën vetëm se denoncoi marrëveshjen e tepsisë PS-LSD), ai tregoi se i përket një race tjetër.

Asaj PS-së së parë, ku mendimi ndryshe respektohet, ku politikanin vlerësohet nga qëndrimet dhe jo nga aftësia për t'u përkulur, ku politika ka vlerë se është një lojë me rregulla dhe parime.

Natyrisht, duke i qëndruar besnik këtij modeli, Majko nuk bëri asgjë më tepër sesa ruajtja e respektit për veten. Ai nderoi historinë e tij personale dhe angazhimet që ka pasur në të shkuarën. Ndërsa për PS ky akt nuk ka më asnjë vlerë. Sepse ajo parti që do të evokojë Majko, tashmë ka vite që ka vdekur. Fatkeqësisht gjesti i tij me shumë se për gjithçka vlen për të na kujtuar këtë.

Lapsi.al

Opinioni *i* Ditës

Dënimi i komplotit terrorist të Iranit në Europë

Alejo Vidal-Quadras

(vijon nga faqja 1)

... demokratike iraniane NCRI në Paris të shtunën më 30 qershor. Dhjetëra mijëra pjesëmarrës nga e gjithë bota ishin të mbledhur në Villepinte jashtë Parisit për të mbështetur thirrjen e udhëheqës-së së opozitës, Maryam Rajavi për një ndryshim demokratik në Iran. Disa qindra figura politike europiane, amerikane dhe ndërkom-bëtare ishin të pranishme në këtë tubim.

Një çift iranian me shtetësi belge u arrestuan nga policia belge të shtunën. Në makinën e tyre u gjetën eksplozivë dhe një detonator, të cilët kishin për qëllim t'i përdornin në mbledhjen në Villepinte. Sipas lajmeve të VTM-së belge, ata eksplozivë, të kombinuar me një bombë me gozha, mund të kishin shkakuar qindra viktima.

Një diplomat iranian nga ambasada në Vjenë është arrestuar gjithashtu në Gjermani si "personi i kontaktit" i terroristëve, sipas zyrës së Prokurorit Publik Belg.

Është tronditëse të dëgjojmë se një sulm terrorist kaq serioz dhe i pamëshirshëm është planifikuar dhe do të realizohet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve iranianë në Europë.

Kjo tregon nivelin e rëndësisë që regjimi iranian i jep lëvizjes së drejtuar nga znj. Rajavi, e cila përfaqëson alternativën demokratike ndaj regjimit teokratik. Plani me dhjetë pika i NCRI përfshin lirinë e shprehjes, të shoqërimit dhe fesë, ndarjen e fesë nga shteti, barazimin midis burrave dhe grave, heqjen e dënimit me vdekje, një Iran jobërthamor si dhe zgjedhje të lira dhe transparente të një Asambleje Kushtetuese brenda gjashtë muajve të parë pas ndryshimit të regjimit. Në janar, presidenti i regjimit iranian, Hassan Rouhani kishte telefonuar Presidentin Ma-



cron për t'i kërkuar Francës të parandalojë veprimtaritë e znj. Rajavi.

Ky atentat i ri terrorist me motive politike në Europë kërkon dënimin e menjëhershëm të regjimit iranian nga Përfaqësuesja e Lartë e BE, Federica Mogherini dhe nga të gjitha shtetet anëtare të BE.

Regjimi i Iranit ka një histori

komplotesh dhe sulmesh terroriste kundër kundërshtarëve të tij në Europë. Në 1997-ën BE tërhoqi ambasadorët e saj nga Irani dhe përjashtoi diplomatët iranianë nga Europa në vijim të vrasjeve famëkeqe të disidentëve kurdë në restorantin 'Mykonos' të Berlinit.

Pas këtij komploti të ri dhe në vijim të valës së vrasjeve të disa kundërshtarëve iranianë vitin e

shkuar, duke përfshirë në Holandë dhe Turqi, BE tani duhet të kërkojë mbylljen e ambasadave të Iranit dhe përjashtimin e diplomatëve iranianë nga Europa.

* Alejo Vidal-Quadras, president, Komiteti Ndërkombëtar në Kërkim të Drejtësisë (ISJ), ish-zëvendës-president i Parlamentit European (1999-2014)

BLUE TOOTH
THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA

te rejat
nga jeta
ipave

con të shtrua talas me

HOROSKOPI

DASHI

Në kontakt me publikun jeni gjithmonë të preferuar, buzëqeshja juaj lehtëson barrën dhe shkrin pakënaqësitë e atyre që janë në pritje. Do të kaloni një mbrëmje shumë të bukur dhe argëtuese në shtëpinë e miqve tuaj.

DEMI

Çifti Merkur-Neptun në shenjë tuaj ju dhuron intuitë të jashtëzakonshme. I perceptoni dëshirat e njerëzve dhe u dilni përpara me entuziazëm. Në negociata dhe komunikim vazhdoni të keni mbarësi: kontakti me publikun stimulon ide të reja.

BINJAKET

Nuk do të jeni në humor të mirë nga ndikimi i Hënës. Çiftit Merkur-Neptun do të jetë armiqësor, ndërsa perceptimet dhe fantazitë ju nxjerrin jashtë rrugës së qëllimit kryesor. Rreziku, në dashuri, është të synosh për shumë lart, sidomos nëse jeni ende beqar.

GAFORJA

Pavarësisht se është ditë pushimi, Hëna ju flet për të punuar. Për fat të mirë, çifti Merkur-Neptun ju mbështet me një përzjerje të mrekullueshme të arsyes dhe intuitës. Një bisnes dhe këndshme, ku ndjenjat shprehin hapur, ndihmon në marrëdhëniet në çift.

LUANI

Udhëtime dhe lëvizje të shumta e gjallërojnë ditën e juaj: mund të jeni në tren, aeroport ose thjesht në makinë, ndoshta për të shkuar të takoni miq të largët. Partneri është kokëfortë dhe tekanjor, tregoni diplomaci duke u treguar dakordësi dhe pastaj bëni si të keni dëshirë.

VIRGJERESHA

Do të keni krijimtari të rafinuar. Arti, fotografia dhe muzika nuk janë thjesht hobi, por mund të kthehen mundësi profesioni. Çifti Merkur-Neptun ju mbështet. Do të keni shumë energji, pasion dhe besim në aftësitë tuaja krijuese.

PESHORJA

Nëse kërkoni për persona ideale, nuk duhet të shikoni shumë larg, ndoshta e keni në krah ose jeni në rrugë për ta takuar. Jepini hapësirë argëtimt dhe lëvizjes së mbrëmjes së sotme, duke pranuar ftesë e miqve që ju kërkojnë.

AKREPI

Do të jetë një ditë e ndërlikuar, nën tërheqjen e Hënës. Edhe çiftin Merkur-Neptun e keni kundra, duke krijuar zënkë në marrëdhënie. Bëni kujdes nga ata, që të bindur se mund t'ua mbushin mendjen, duke ju premtuar qiellin dhe tokën, sepse nga pas ka një klikekë.

SHIGJETARI

Do të jeni shumë të frymëzuar. Instinkti do t'ju japë udhëzimet e duhura për të arritur pa shumë përpjekje drejt suksesit. Do të përjetoni gjallërinë e miqësisë dhe dashurisë dhe si edhe puna do të ecë. Më në fund po filloni të fitoni.

BRICJAPI

Ana e mirë e Merkurit dhe Neptunit garanton frymëzimin krijuese dhe udhëtime në intimitetin e shpirtit. Do t'ju vijin mesazhe romantike nga larg. Do të keni harmoni në vendin e punës. Nuk do të keni rivalitet me kolegët. Shpirti i skuadrës është në interes të grupit.

UJORI

Do të përshkoheni nga ndjenja e të qenit zotërues, ndoshta me shumë një qëndrim sesa një nevojë e thellë: një ekip ju pëlqen të theksoni se ai ose ajo është tashmë... pronë private. Do t'i pëshpërtin në vesh partnerit gjera konfidenciale. Fillet më bukur për dashurinë në intimitetin e shtëpisë së juaj.

PESHQIT

Do të mbizotërojë shpirti i skuadrës me kolegët, kur njëri nuk ia deli ndihmon tjetrit, pa zili dhe kritika, për të arritur objektivin. Investimet do të duhet të monitorohen: konsultohuni me një ekspert të kësaj fushë. Do të bëni blerje interesante në librari.



Dëmtimi është i rëndë

Vrsaljko humbet gjysmëfinalen me Anglinë

Përfaqësuesja kroate do të jetë e detyruar të bëjë ndryshime në ndeshjen më të rëndësishme të historisë së saj përballë Anglisë në Rusi 2018, për shkak të mungesave në formacion. Pas vizitave të sotme mjekësore

është konfirmuar se Simo Vrsaljko do të mungojë për shkak të dëmtimit që pësoi në ndeshjen ndaj Rusisë. Mbrojtësi i krahut është një nga elementet më cilësore të Kroacisë dhe mungesa e lojtarit do të sjellë ndryshime

në prapavijë duke kthyer me shumë mundësi veteranin Čorluka me titullarëve për të zënë vendin e tij. Vrsaljko do të vazhdojë riaftësimin e tij, pasi nuk përfundoi mundësia që të jetë i gatshëm për ndeshjen tjetër

që do të zhvillojë përfaqësuesja kroate, qoftë ajo finalja e madhe apo ndeshja e vendit të tretë. Kjo është mungesa e dytë për Kroacinë për këtë duel, duke llogaritur se përfaqësuesja në fjalë ka përballuar turneun me një futbollist me një ekip si Franca duhet të jesh i përgjendur gjatë 90 minutave. Kjo nuk është nga ato ndeshje ku ke kohë të mendosh se çfarë ke bërë ndaj Brazilit me shpresë se do të të ndihmojë. Në kemi cilësi të atillë në grup që na ka dhënë aftësinë për të ndryshuar në varësi të kundërshtarit. Gjatë grumbullimeve me ekipet kombëtare ke vetëm një apo dy seanca stërvitore për të përgatitur një ndeshje, ndaj inteligjenca e një ekipi është një ndihmesë e madhe. Për mua është shumë domethënëse që 20 lojtarë të ekipit kanë kontribuar në këtë fushatë botërore. Në stërvitjen e radhës për kombëtaren e Belgjikës ka rënë në sy mungesa e pesë futbollistëve, të cilët janë në formacionin titullar të belgëve. Eden Hazard, Romelu Lukaku, Vinsent Kompani, Aksel Vigel dhe Tomas Mënie nuk kanë zhvilluar seancën stërvitore me pjesën dërrmuese të grupit. Teksa për Mënie flitet se po riaftësohet për një dëmtim të lehtë të pësuar ndaj Brazilit, nuk dihet arsyja e mungesës së katër yjeve të tjerë. Nuk shqetëson gjendja e mbrojtësit të djathtë, pasi sidomos ai do të mungojë ndaj Francës për shkak skualifikimi.

Francë-Belgjikë do të luhet në Shën Pjetërburg. "Gjelat" dhe "Djajtë" janë ambiciozë



Jeton Selimi

Dëshamp: Dua të luaj në finale.
Martinez: Ne, ekip inteligjent
Umtiti rrezikon, Mënie i skualifikuar

Didie Dëshamp ishte lojtari që udhëhoqi Francën në triumfin e saj të vetëm në një Botëror në vitin 1998. Mesfushori shtatshkurtër ishte kapiten i "gjelave" dhe pas fitores 3-0 kundër Brazilit, ngriti në qiellin e Parisit trofeun e madh. Sot, si trajner, e ka kualifikuar Francën në gjysmëfinalen e Kupës së Botës "Rusi 2018", me shpresën për të rikthyer në Francë pas 20 vjetësh, tashmë si trajner, kupën aq të lakmuar. "Gjithçka që duam të them është se jemi në gjysmëfinale dhe kemi shansin të luajmë finalen e një Kupë Bote, ndaj do të provojmë çdo gjë. Të martën do të japim gjithçka për të shkuar në finale. Kam potencial në ekip, kualiteti në individë është i dukshëm. Kjo skuadër është më e re sesa ekipi që luajti në Euro 2016, por kanë shumë eksperiencë në nivel klubesh. Do të jemi kompetitivë. Në dy apo katër vjet do të kemi një ekip të jashtëzakonshëm. Potenciali për progres është i dukshëm. Por ta nisim nga gjysmëfinalja. Mbase unë jam në vendin e duhur në momentin e duhur dhe kemi punuar fort, por ndeshjet u takojnë lojtarëve.



Unë kam rolin tim, por është shumë më ndryshe." Sa i takon formacionit me të cilin Franca do të përballlet me Belgjikën, Dëshamp ka një rik-

thim të rëndësishëm në mesfushë, siç është Blez Matuidi, që nuk luajti në cerekfinalin për shkak pezullimi, ndërsa në mbrojtje duhet të bëjë

vlerësimet e duhura. Samuel Umtiti nuk është stërvitur nësoj si shokët e tij në seancat e fundit për shkak të një problemi më shpatullën e majtë,

ndaj gjendja e tij ka sjellë shqetësim pasi rrezikon prezencën në fushën e lojës kundër Belgjikës.

BELGJIKA

Numrat e Belgjikës janë të një ekipi favorit për një Botëror. Deri më tani, "Djajtë e Kuq" kanë qenë të vetmit që kanë triumfuar në të pesta ndeshjet e luajtura, pa qenë e nevojshme që të kalojnë në kohën shtesë apo në gjuajtjet e penalltive. Ndër të tjerë, Romelu Lukaku me shokë kanë edhe sulmin më të mirë të veprimtarisë, 14 gola në total, ku pjesa më e madhe e tyre ka qenë meritë e sulmuesit të Junajtidit, çka dëshmon edhe punën e madhe të djemve të Martinezit. "Është një mundësi e madhe për ne dhe një cmim për atë që kemi bërë në 15 vitet e fundit. Është një mundësi unike të jesh në një Kupë Bote dhe aq më tepër në gjysmëfinale kundër Francës.

MESFUSHORI

Hazar trondit belgët: Unë, tifoz i Francës

Një ndër lojtarët më të mirë në botë dhe absolutisht protagonist në sukseset e Belgjikës, është sulmuesi i Çelsit, Eden Hazard. Me lojën dhe golat e tij, Hazard di të bëhet një futbollist i aftë për të përcaktuar fatin e ndeshjes. Në këtë Botëror, Hazard së bashku me Belgjikën, kanë arritur të kualifikohen për në gjysmëfinalen e Kupës së Botës, aty ku përballë do të

kenë Francën e drejtuar nga Didier Dëshamp. Në prag të këtij takimi, Hazard ka folur për lidhjen që ai ka me kombëtaren franceze. "Dikur nuk kishim fanella të Belgjikës dhe vishnim të Francës. Kam qenë më shumë tifoz i francezëve sesa i belgëve. Pa dashur për të hedhur poshtë Belgjikën, Franca në atë kohë ishte... Francë. Mbase? Ai është një lojtar shumë i mirë dhe i talentuar. Nëse ai shihte videot e mia kur



ka qenë i vogël, sot unë shoh videot e tij pasi është fantastik", -u shpreh Hazard.

Ish-trajneri i Barcelonës

Spanja zgjedh Luis Enrike në krye të "Furia Rohas"

Luis Enrike, ish-trajneri i Barcelonës dhe ish-lojtari i Real Madridit, është trajneri i ri i Spanjës. Ai do të zëvendësojë në këtë post Fernando Hieron. Federata Spanjolle ka miratuar njëzëri punësimin e tij deri në "Euro 2020", me propozimin e presidentit Luis Rubiales. Ai ka nënshkruar për dy vjet, nuk do të ketë klauzolë largimi dhe do të vijë me stafin e tij teknik: do të propozojë Huan Karlos Unzuë (trajner i dytë) dhe Rafel Pol (trajner fizik). Të dy e shoqëruan atë në Barcelonë, por FEF duhet të negociojë me ta. Gjithashtu, përfshinë një psikolog, Hoaguin Valdes. Trajneri i ri do të publikojë listën e tij të parë më 31 gusht. Ai do të zgjedhë 23 lojtarë për të luajtur kundër Anglisë në "Uembli" më 8 shtator dhe

kundër Kroacisë më 11 shtator në stadiumin "Martinez Valero" në Elke, në dy ndeshjet e para të Ligës së Kombeve. Trajneri 48-vjeçar do të paraqitet zyrtarisht në ditët në vijim dhe ka pasur më shumë mbështetje se dy kandidatët e tjerë, Kike Sanchez Flores dhe Mishel. Luis Enrike, së bashku me drejtorin e ri sportiv të RFEF, Hosë Francisco Molina, do të bëjnë planin për ekipin e ri, ndër sfidat e tjera, ata propozojnë që ta bindin Pike që të rishqyrtojë vendimin e tij për të lënë ekipin kombëtar dhe të zëvendësojë me lojtarë

të rinj tashmë të konfirmuar, largimin e mesfushorit Injesta dhe më shumë se sa duket Silva, i cili, gjithashtu, duket i gatshëm për të ndjekur ish-yllin katalanas. Çështje të tjera të pazgjidhura janë: vazhdimësia apo Jo e portierit De Gea në pikëpyetje dhe moduli i ri taktik. Spanja la për të dëshiruar në këtë Botëror dhe një revolucion pritet të ndodhë me në krye Luis Enrike, i cili suksesin më të madh e pati me Barcelonën duke fituar tripletën me katalanasit

